

GJYKATA E APELIT
NË EMËR TË POPULLIT

Lënda numër: PAKR 299/16

Datë: 19 dhjetor 2016

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar referues, dhe gjyqtarja e EULEX-it Anna Bednarek dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës Driton Muharremi, si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Noora Aarnio-s, oficerë ligjore e EULEX-it, si proces-mbajtëse,

në lëndën penale kundër

OI,

DD,

NV,

IV,

AL,

të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS 04/2013, datë 8 gusht 2014, e paraqitur në Gjykatën Themelore më 11 gusht 2014, si më poshtë:

- 1) **Krime Lufte kundër Popullatës Civile**, në shkelje të rëndë të Nenit 3 § 1(a) të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 Lidhur me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte, dhe Nenit 4 § 2(a) të Protokollit Shtesë II Lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare, të datës 8 qershor 1977, sipas nenit 152 § 1 dhe 2.1, lidhur me nenet 16 dhe 32 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale nga Neni 142 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të datës 28 shtator 1976 (KPRSFJ) (OI),
- 2) **Nën-akuza 1: Nxitje për Kryerjen e Veprës Penale të Vrasjes së Rëndë në Bashkëkryerje** në formën e privimit të jetës së një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje, dhe në shkelje të nenit 179 (1.10), lidhur me nenet 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale në bazë të nenit 30 paragrafi (2) të LPPSAK, lidhur me nenet 22 dhe 23 të KPRSFJ; (OI dhe DD),

Nën-akuza 2: Nxitje për Kryerjen e Veprës Penale të Tentim Vrasjes së Rëndë në Bashkëkryerje në formën e privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, nga Neni 179

(1,10) dhe Neni 189 (2.1) dhe (5), lidhur me nenet 28, 31 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale në bazë të nenit 30 paragrafi (2) dhe nenit 38 paragrafi (2) të LPKSAK, lidhur me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ; (OI dhe DD),

Nën-akuza 3: Nxitje për Kryerjen e Veprës Penale të Tentim Vrasjes së Rëndë në Bashkëkryerje në formën e privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje, nga neni 179 (1.10) lidhur me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale në bazë të nenit 30 paragrafi (2) të LPKSAK, lidhur me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ; (OI dhe DD),

- 3) **Nën-akuza 1: Vrasje e Rëndë në Bashkëkryerje** në formën e privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje, nga Neni 179 § 1.10, lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe e dënueshme në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenin 22 të KPRSFJ; (NV, IV dhe AL),

Ad.2: Tentim Vrasje e rëndë në bashkëkryerje në formën e privimit të jetës së një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, sipas nenit 179 § 1.10 dhe nenin 189 § 2.1 dhe 5 lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPK-së dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale në bazë të nenit 30 § 2 dhe neni 38 § 2 të LPKSAK lidhur me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ ; (NV, IV dhe AL)

Nën-akuza 3: Tentim Vrasje e Rëndë në Bashkëkryerje në formën e privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje, nga neni 179 § 1.10, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPK-së, dhe e dënueshme në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së; (NV, IV dhe AL)

gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me Aktgjykimin P. nr. 98/2014, të datës 30 mars 2016, si në vijim:

O u gjet fajtor për **Akuzën 1**, vepra penale e *krimin të luftës kundër popullatës civile*, veprë e dënueshme sipas nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) dhe në shkelje të Nenit 3 § 1(a) të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 Lidhur me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë, dhe Nenit 4 § 2(a) të Protokollit Shtesë II Lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare, të datës 8 qershor 1977.

I pandehuri OI u dënua me 9 vite burgim. Ai u urdhërua gjithashtu të paguajë shumën prej 750 eurosh, si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale.

Lidhur me **Akuzën 2, nën-akuza 1**, të pandehurit OI dhe DD u shpallën të pafajshëm dhe u liruan nga kryerja e veprës penale të *nxitjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në formën e privimit nga jeta të personit tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje*, nga neni 179 § 1.10, lidhur me nenet 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e

kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenet 22 dhe 23 të KPRSFJ-së.

Lidhur me **Akuzën 2, nën-akuza 2**, të pandehurit **OI** dhe **DD** u shpallën të pafajshëm dhe u liruan nga vepra penale e *nxitjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në formën e privimit nga jeta të një personi tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje*, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, nga neni 179 § 1.10 dhe neni 189 § 2.1 dhe 5, lidhur me nenet 28, 31 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 dhe neni 38 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ;

Lidhur me **Akuzën 2, nën-akuza 3**, të pandehurit **OI** dhe **DD** u shpallën të pafajshëm dhe u liruan nga vepra penale e *nxitjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në formën e privimit nga jeta të personit tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje*, nga neni 179 § 1.10, lidhur me nenet 28, 31 dhe 32 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenet 19, 22 dhe 23 të KPRSFJ-së;

Lidhur me **Akuzën 3, nën-akuza 1**, të pandehurit **NV, IV** dhe **AL** u shpallën të pafajshëm dhe u liruan nga akuza për kryerjen e veprës penale të *vrasjes së rëndë në formën e privimit nga jeta të personit tjetër për shkak të motiveve kombëtare në bashkëkryerje*, nga neni 179 § 1.10, lidhur me nenet 31 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenin 22 të KPRSFJ.

Lidhur me **Akuzën 3, nën-akuza 2**, të pandehurit **NV, IV**, dhe **AL** u shpallën të pafajshëm dhe u liruan nga akuza për veprën penale të *vrasjes së rëndë në formën e privimit nga jeta të personit tjetër, për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje*, duke rezultuar në lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, nga neni 179 § 1.10 dhe neni 189 § 2.1 dhe 5, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 dhe neni 38 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së;

Lidhur me **Akuzën 3, nën-akuza 3**, të pandehurit **NV, IV** dhe **AL** u shpallën të pafajshëm dhe u liruan nga akuza për veprën penale të *vrasjes së rëndë në formën e privimit nga jeta të personit tjetër për shkak të motiveve kombëtare, në bashkëkryerje*, nga neni 179 § 1.10, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPK-së, dhe e dënueshme edhe në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30 § 2 të LPKSAK, lidhur me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së;

Të dëmtuarit **XS, SK, KA**, si dhe **RA, SA, EX, GX, GS, SC, LA, HS, HR, MH** dhe **UA** u udhëzuan të paraqesin kërkesë-padi pronësore në kontest civil, në bazë të nenit 463 paragrafi (1) të KPP-së. Kolegji nuk e trajtoi kërkesë-padinë pasurore të paraqitur nga M L pasi nuk u vlerësua se ai kishte cilësinë e palës së dëmtuar në këtë lëndë.

Duke vendosur lidhur me ankesat e mëposhtme, të paraqitura kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, P. nr. 98/2014, të datës 30 mars 2016

- ankesa e **OI** personalisht, e paraqitur më 18 prill 2016
- ankesa e mbrojtësve në emër të **OI**, e paraqitur më 18 prill 2016
- ankesa e Prokurorit të EULEX-it Romulo Mateus, e paraqitur më 19 prill 2016

pas shqyrtimit të përgjigjeve të paraqitura si në vijim

- 1) më 3 maj 2016 nga ana e prokurorit;
- 2) më 3 maj 2016 nga Nebojša Vlajić dhe Ljubomir Pantović (për **OI**);
- 3) më 10 maj 2016 nga Miodrag Brkljač (për **DD**);
- 4) më 28 prill 2016 nga **N V** ;
- 5) më 27 prill 2016 nga Zarko M. Gajic (për **N V**);
- 6) më 27 prill 2016 nga Dobrica Lazić (për **IV**);
- 7) më 4 maj 2016 nga Živojin Jokanović (për **AL**);

dhe kërkesës së Prokurorit të Apelit të paraqitur më 1 korrik 2016

pasi mbajti seancat publike të Kolegjit të Apelit më 28 shtator 2016 dhe 11 dhe 12 tetor 2016, si dhe një seancë dëgjimore më 22 nëntor 2016;

pasi u këshillua dhe votoi më 24 dhe 25 tetor 2016, 30 nëntor 2016 dhe 19 dhjetor 2016,

në bazë të neneve 389, 390, 391, 392, 393, 394 dhe 398 të KPP-së,

shqipton këtë

AKTGJYKIM

- I. Ankesa personale e OI , e paraqitur më 18 prill 2016 dhe ankesa e mbrojtësve Nebojša Vlajić dhe Ljubomir Pantović në emër të OI , të paraqitura më 18 prill 2016, të dyja lidhur me Akuzën 1, pranohen pjesërisht.**
- II. Ankesa e Prokurorit të EULEX-it Romulo Mateus, e paraqitur më 19 prill 2016 refuzohet si e pabazuar.**
- III. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, P. nr. 98/2014, i datës 30 mars 2016, anulohet lidhur me Akuzën 1, dhe lënda kthehet për rigjykim për këtë Akuzë. Aktgjykimi konfirmohet lidhur me Akuzat 2 dhe 3.**
- IV. Paraburgimi kundër të pandehurit OI vazhdohet deri sa Gjykata Themelore e Mitrovicës të marrë aktvendim në bazë të nenit 193 të KPP-së.**

ARSYETIM

I. HISTORIKU PROCEDURAL RELEVANT

Përshkrimi i procedurës deri në shpalljen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës mund të gjendet në Aktgjykimin e datës 30 mars 2016.¹

Aktgjykimi me shkrim iu dorëzua **OI** më 4 prill 2016 dhe mbrojtësve të tij Nebojša Vlajić dhe

¹ Faqet 26 - 28

Ljubomir Pantović më 4 prill 2016; **DD** më 5 prill 2016 dhe mbrojtësit të tij Miodrag Brkljač më 4 prill 2016; **NV** më 4 prill 2016 dhe mbrojtësit të tij Zarko M. Gajic më 4 prill 2016; **IV** më 4 prill 2016 dhe mbrojtësit të tij Dobrica Lazić më 4 prill 2016; **AL** më 4 prill 2016 dhe mbrojtësit të tij Živojin Jokanović më 5 prill 2016, mbrojtësit të viktimës **BM** i më 4 prill 2016; dhe Prokurorit të EULEX-it më 4 prill 2016.

Ankesat dhe përgjigjet u paraqitën siç u përshkruan më sipër.

Lënda u transferua në Gjykatën e Apelit për një vendim lidhur me ankesën e 25 majit 2016.

Më 1 korrik 2016, Prokurori i Apelit paraqiti një kërkesë.

Më 19 gusht 2016 mbrojtësit e të pandehurit I kërkuan, ndër të tjera, që vendi i mbajtjes së seancës së Gjykatës së Apelit të ndryshohet në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Më 22 shtator 2016 kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit vendosi ta refuzojë kërkesën.

Seancat e Gjykatës së Kolegjit Apelit u mbajtën më 28 shtator 2016 dhe 11 dhe 12 tetor 2016 në praninë e Prokurorit të Apelit Lars Agren, përfaqësuesit të të dëmtuarve **BM**, mbrojtësve Nebojša Vlajić dhe Ljubomir Pantović (për **OI**), mbrojtësve Miodrag Brkljač and Dejan Vasic (për **DD**), mbrojtësit Zarko M. Gajic (për **NV**), mbrojtësit Dobrica Lazić (për **IV**), dhe mbrojtësit Živojin Jokanović (për **AL**).

I pandehuri **OI** mori pjesë në seanca. Të pandehurit **DD**, **NV**, **IV**, dhe **AL** u ftuan në mënyrë të rregullt për seancën, siç tregohet nga fletë-dërgesat në shkresat e lëndës, por nuk morën pjesë. Të dëmtuarit morën pjesë si më poshtë: **IM**, **KA**, **SC** i dhe **HS** më 28 shtator 2016, **GX** dhe **SC** më 11 tetor 2016, dhe **SK** dhe **SC** më 12 tetor 2016.

Kolegji i Apelit u këshillua dhe votoi më 24 dhe 25 tetor 2016 dhe vendosi të mbajë seancë lidhur me Akuzën 1 dhe çështjen *ne bis in idem*.

Seanca u mbajt më 22 nëntor 2016 lidhur me Akuzën 1 dhe çështjen *ne bis in idem*. Të pranishëm ishin Prokurori i Apelit Lars Agren, përfaqësuesi i të dëmtuarve **BM**, mbrojtësit Nebojša Vlajić dhe Ljubomir Pantović (për **OI**), dhe i pandehuri **OI**. Pala e dëmtuar **SK** ishte i pranishëm.

I. ANKESA E PROKURORIT DHE PËRGJIGJET NDAJ SAJ

Prokurori i PSRK-së Romulo Mateus paraqiti ankesë më 19 prill 2016 në Gjykatën Themelore për arsye të:

Lidhur me Akuzën 1:

- vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas nenit 383 (1.3) lidhur me nenin 386 (3) të KPP-së;

- vendimit për dënimet penale, sipas nenit 383 (1.4) lidhur me nenin 387 (1) dhe (2) të KPP-së.

Lidhur me Akuzën 1, Prokurori propozon të konfirmohet dënimi i **OI** dhe të ndryshohet aktgjykimi lidhur me dënimin duke e rënduar dënimin.

Lidhur me Akuzën 1 Prokurori mendon se vërtetimi i gjendjes faktike nga Gjykata Themelore është i gabuar dhe jo i plotë lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si dhe me dënimin.

Sa u përket rrethanave rënduese Prokurori vë në dukje se jurisprudenca ndërkombëtare në përgjithësi dhe Neni 41 (1) i KPRSFJ-së e njohin pozitën e eprorit si faktor rëndues, kur ai nuk është një element i veprës penale. Më tej, Prokurori vë në dukje se pozicioni si udhëheqës i grupit mund të krijohet *de jure* ose *de facto*. Prokurori pohon se **OI** kishte pozitën e udhëheqësit mbi policinë/njësinë paraushtarake serbe që ishte në përcjellje të nëntë shqiptarëve të cilët do të ekzekutoheshin. Kjo mund të konkludohet nga faktet e mëposhtme: nëntë shqiptarë nuk ishin dëmtuar në mënyrë të pariparueshme para ndërhyrjes së **OI**, por ishin fjalët e tij ato që vunë në lëvizje skuadrën e ekzekutimit; gjatë operacionit të spastrimit **OI** ishte pjesë e policisë/paraushtarakëve në pikën e kontrollit; këshilla e tij u kërkuar edhe pasi më parë kishte vendosur në mënyrë të pavarur të liroheshin gjashtë shqiptarë; atij i drejtoheshin si “shef”; ai qëndroi përpara grupit të armatosur; ai qëndroi vetëm pak metra larg ekzekutimit; urdhrat e dhëna nga **I** as u vunë në pikëpyetje, as u kundërshtuan, as prapësuan, por u zbatuan menjëherë nga të gjithë njerëzit, ndryshe nga urdhrat e dhëna nga ushtari për të ndalur vrasjet; në atë kohë Ivanoviç ishte në përgjithësi një figurë e njohur, udhëheqës i shquar. Kështu që Gjykata Themelore dështoi ta vërtetonte këtë fakt.

Më tej Prokurori vëren që jurisprudenca ndërkombëtare në përgjithësi, si dhe Neni 41 (1) i KPRSFJ-së, e njeh shpërdorimin e pushtetit si faktor rëndues. Prokurori po ashtu pohon se **OI** e shpërdoroi pushtetin e tij si epror, kur ekzekutoi urdhrin për të vlarë shqiptarët, megjithëse ai kishte fuqinë, autoritetin dhe zgjedhjen ta pezullonte urdhrin e dhënë më parë. Kështu që Gjykata e vërtetoi në mënyrë të gabuar gjendjen faktike pasi ajo dështoi të përcaktonte shpërdorimin e pushtetit nga ana e **OI**.

Prokurori gjithashtu thekson se e drejta ndërkombëtare, si dhe Neni 41 (1) i KPRSFJ-së, njeh mundësinë jo vetëm të bashkë-kryerjes në një veprë penale, por edhe të nxitjes së dikujt për të kryer të njëjtën veprë penale. Prokurori në këtë mënyrë pohon se nxitësi mund të marrë pjesë në veprën penale që ai nxiti, ashtu siç mund të jetë edhe udhëheqës, edhe nxitës. Për më tepër, mjafton që nxitësi të “kontribuojë ndjeshëm” në veprën penale – nuk është parakusht që i nxituri nuk ka vendosur ta kryejë veprën penale. Meqenëse përgjigja e **OI** “Vetëm zbatoni urdhrat” nxiti vrasjet menjëherë dhe pa i vënë në pikëpyetje, midis urdhrat të tij dhe veprës penale ekziston një lidhje shkakësore. Së fundi, pasi që vrasja u ndalua nga personi i veshur me të gjelbër, është e palogjikshme që vrasjet të kishin filluar pa miratimin e **OI**. Kështu që udhëzimet e **OI** luajtën rol kryesor në vrasjet – një situatë faktike që Gjykata Themelore dështoi ta përcaktonte dhe, kështu, e vërtetoi në mënyrë të gabuar.

Prokurori vë në dukje më tej se e drejta ndërkombëtare, si dhe Neni 41 (1) i KPRSFJ-së, e njeh si faktor rëndues gjendjen mendore diskriminuese, kur ajo nuk është element i veprës penale.

Prokuroria pretendon se **OI** ishte në dijeni të dëbimeve dhe vrasjes së shqiptarëve për shkak të përkatësisë së tyre etnike, por ai veproi në përputhje me këtë urdhër me dëshirë. Më tej, motivimi diskriminues etnik nuk është element i veprës penale të “Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile”, sipas nenit 142 të KPRSFJ-së.

Prokurori gjithashtu vëren se e drejta ndërkombëtare, si dhe Neni 41 (1) i KPRSFJ-së, e njeh si faktor rëndues situatën veçanërisht të pambrojtur të viktimës, kur ajo nuk është element i veprës penale. Prokurori pohon se gjatë konfliktit në Kosovë, të drejtat themelore njerëzore të shqiptarëve u shpërfillën dhe forcat serbe u sollën në mënyrë të paligjshme kundër tyre. Gjatë operacionit të spastrimit nuk u bë asnjë përjashtim. Në këtë situatë viktimat nuk kishin mjet efektiv për të mbrojtur veten apo për t’i shpëtuar sulmit.

Së fundi, Prokurori vë në dukje se e drejta ndërkombëtare, si dhe Neni 41 (1) i KPRSFJ-së, i njeh si faktor rëndues mënyrën veçanërisht mizore të kryerjes së një vepre penale dhe vuajtjet e viktimave. Prokurori thekson se personat që prisnin në radhë ishin në gjendje të dëgjonin atë që po ndodhte pas tyre. Në këtë situatë, frika për jetën e tyre dhe gjithashtu tronditja nga humbja e jetës së të tjerëve mund të konsiderohet vetëm si mizore.

Në përfundim Prokurori thekson se Gjykata Themelore gaboi kur nuk i mori parasysh këta faktorë rëndues në vendosjen lidhur me dënimin.

Sa u përket rrethanave lehtësuese, Prokurori pohon se niveli i pjesëmarrjes së **OI** nuk ishte i ulët. Përkundrazi, ai nuk qe një spektator pasiv, por luajti rol qendror dhe shprehu mbështetjen e tij për “planin e përgjithshëm”. Më tej, Gjykata Themelore nuk specifikoi se çfarë përbënte “karakter të mirë” të **OI**, apo përse ky ishte një faktor lehtësues. Gjithashtu, prokuroria mendon se është groteske që dikush që ka kryer veprën penale të krimeve të luftës, vrasje dhe tentim vrasje, me qëllim diskriminues për shkak të përkatësisë etnike, do të gjendej se ka qëndrim miqësor ndaj të njëjtit grupi etnik. Prokurori mendon se përkundrazi, qëndrimi nacionalist i **OI** mund të shihet edhe sot. Në fund, prokurori e gjen mjaft diskriminuese kur një Gjykatë e konsideron inteligjencën e një personi si rrethanë lehtësuese, pasi kjo do të thotë patjetër që njerëzit e paarsimuar dhe më pak inteligjentë duhet të mbahen në burg më gjatë për të njëjtat krime.

Në përfundim, Prokurori deklaron se Gjykata Themelore gaboi kur i mori parasysh këta faktorë lehtësues në vendosjen lidhur me dënimin.

Sa i përket dënimit, Prokurori pohon se dënimi i vendosur prej 9 vjetësh burgim është tepër i butë. Prokuroria i referohet jurisprudencës kombëtare dhe vëren se në raste të ngjashme të pandehurit janë dënuar me dënim më të rëndë.

Lidhur me Akuzën 2:

- shkeljes esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 383 (1.1) lidhur me nenin 384 (2.1) të KPP-së;

- vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 383 (1.3) lidhur me nenin 386 (3) të KPP-së.

Lidhur me Akuzën 2, Prokurori propozon të ndryshohet Aktgjykimi duke e dënuar **OI** dhe **DD** sipas akuzës në Aktakuzë. Prokurori më tej kërkon që Gjykata e Apelit të pranojë si provë të X dokument.

Lidhur me Akuzën 2, prokuroria në fillim diskuton për “Rojet e urës”, pastaj për provat e reja, ndjekur nga nxitja dhe bashkë-kryerja, dhe me vërejtjet përfundimtare dhe përfundimin.

“Rojet e Urës”

Së pari, Prokurori pohon se Gjykata Themelore ka shkelur kodin e procedurës penale pasi Aktgjykimi nuk deklaron në mënyrë të qartë dhe shteruese se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë (Neni 370 (7) i KPP-së). Kjo qasje lë dyshim nëse Gjykata Themelore i ka vlerësuar provat në mënyrë shteruese.

Në veçanti, Prokurori deklaron se dëshmitarëve **NK** dhe **NS** u mungon objektiviteti dhe besueshmëria për shkak të pikëpamjeve të tyre nacionaliste dhe njëanshmërisë së dukshme. Kështu që përfundimi i bazuar në dëshmitë e tyre se **OI** nuk ishte organizatori dhe udhëheqësi i Rojeve të Urës, është i gabuar. Më tej, Gjykata Themelore nuk shqyrtoi mënyrë të qartë dhe shteruese çdo provë, pasi ajo identifikon vetëm deklaratat e **BP** dhe **NK** kur përcakton se **OI** ishte “thjesht” një anëtar i Bordit të KNS. Gjykata Themelore as shpjegon se pse në këtë çështje ajo i besoi dëshmisë së **OI**. Këto gabime të çojnë në një vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Lidhur me dëshminë e **FH**, Prokurori mendon se ajo nuk është kontradiktore, por thjesht u referohet periudhave të ndryshme kohore – para dhe pas bombardimeve të NATO-s. Gjithashtu, deklaratat e tij lidhur me xhemperin sportiv dhe një jakne blu me simbole serbe u vërtetuan nga deklaratat e Dëshmitarit Y, videoja japoneze dhe dëshmitari **IR**. As ka kontradiktë të vërtetë në deklaratën e Hysenit lidhur me aktivitetet e **OI**, pasi dëshmitari përshkroi se e kishte parë atë duke komanduar një njësi të çdo lloji vetëm pas luftës. Gjithashtu, pretendimi i **FH** lidhur me dhunën e Rojeve të Urës para syve të KFOR-it francez mbështetet nga prova të tjera. Prandaj Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar dëshminë e **FH** ashtu siç kërkohet nga KPP, çka rezultoi në përdhënim të gabuar të gjendjes faktike.

Përveç dëshmisë së Dëshmitarit Y, Gjykata Themelore nuk i deklaron qartësisht provat sipas të cilave konstatohet se ka pasur njëfarë lidhjeje mes Rojeve të Urës dhe MPB-së. Prandaj Aktgjykimi nuk i plotëson kërkesat e nenit 370 (7) të KPP-së dhe në këtë drejtim çon në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Për më tepër, dëshmia e Dëshmitarit Y se ai nuk i njihnte shumë prej Rojeve të Urës personalisht shpjegohet logjikisht me faktin se shumë prej tyre nuk e kishin origjinën nga Mitrovica e Veriut dhe se ai nuk i merrte ata seriozisht. Por kjo është e paarsyeshme të nxjerrësh nga kjo përfundimin, siç ka bërë Gjykata Themelore, se Rojeve të Urës nuk ishin një strukturë e organizuar. Provat e mëtejshme të cituara nga Gjykata Themelore – deklaratat e **S** dhe **D** – nuk mund të jenë të mbështetshme pasi ato janë të njëanshme për shkak të pikëpamjeve nacionaliste. Më tej prokurori mendon se Gjykata Themelore dështoi pa asnjë shpjegim të vlerësujtë dëshminë e Dëshmitarit Y në tërësi. Sikur ta kishte bërë këtë, ajo mund të kishte arritur vetëm në

përfundimin se Rojeve të Urës ishin një strukturë shumë e organizuar dhe si e tillë duhej të kishte një udhëheqës. Prokurori gjithashtu vë në dukje se Gjykata Themelore dështoi të shpjegojë se përse ajo, kundër dëshmisë së Dëshmitarit Y, nuk e konsideroi **OI** udhëheqës. Kur nuk u pajtua me konkluzionet e Dëshmitarit Y lidhur me dy incidente ku ai kishte qenë dëshmitar, Gjykata Themelore bëri një vlerësim jo të plotë dhe e vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të gabuar. Gjithashtu, siç u përmend më parë, Gjykata Themelore nuk arriti të bëjë lidhjen ndërmjet dëshmisë së Dëshmitarit Y lidhur me një jaknen karakteristike që vishte **OI**, si dhe dëshmisë së **FH**, me jaknen e parë në videon japoneze. Meqenëse kjo jakne e lidh Ivanoviçin me Rojeve të Urës, dhe gjithashtu me anëtarin **DD** të MPB-së, Gjykata Themelore dështoi përsëri të vlerësojë çdo provë në mënyrë të qartë dhe shteruese. Së fundi, Gjykata Themelore shkeli kodin e procedurës penale kur e ndaloi Prokurorin t'i bënte pyetje sqaruese Dëshmitarit Y.

Sa i përket Dëshmitarit X, qasja e përgjithshme e Gjykatës Themelore për të diskredituar dëshminë e tij si thashetheme ishte e parregullt, pasi ai dëshmoi edhe për gjëra që i kishte parë vetë. Dëshmitë në procedurën paraprake dhanë informacion të detajuar rreth Rojeve të Urës, si dhe vendosjes së lidhjes mes **OI** dhe **DD**. Më vendimtarja, dëshmia e Dëshmitarit X dhënë në shqyrtimin gjyqësor duhet të krahasohet në hollësi me dëshminë e tij në procedurën paraprake, pasi ato ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Prokuroria thekson se mospërputhjet dhe lëshimet lidhur me deklaratën e tij në procedurën paraprake nuk u sqaruan në shqyrtimin gjyqësor para Gjykatës. Përkundrazi, kryetari i trupit gjykues e ndaloi Prokurorin ta ballafaqonte dëshmitarin me kontradiktat. Prokurori kujton se, megjithëse ka pasur një ndryshim të madh filozofik në kodin e procedurës penale, për t'u përqendruar më shumë në mbrojtjen e të drejtave të palëve dhe në gjykim, dhe më shumë drejt një sistemi akuzator, sistemi aktual është një sistem hibrid që ende e lejon trupin gjykues të mbledhë prova për të përmbushur detyrimin e tij për “vërtetimin e drejtë dhe të plotë të çështjes”. Prandaj, duke mos sqaruar mospërputhjet dhe lëshimet në deklaratë, Gjykata Themelore shkeli detyrimin e saj për të gjetur të vërtetën – një shkelje që rezultoi në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Për më tepër, frikësimi i dëshmitarëve ishte qartazi problem.

Më tej, Prokurori pohon se një pjesë e madhe e provave nuk u vlerësuan fare, dhe për këtë arsye provat nuk u vlerësuan në mënyrë shteruese.

Gjykata Themelore nuk vlerësoi çdo provë veç e veç. Gjykata Themelore as i mori parasysh provat në lidhje me provat e tjera, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve X dhe Y, për shembull. Ajo gjithashtu nuk mori parasysh disa deklaratatë të dëshmitarëve lidhur me disa çështje, të tilla si deklaratatë e **BR** lidhur me organizimin e Rojeve të Urës, dëshmia e **GR** lidhur me ndikimin e **OI** tek Rojeve të Urës, ose dëshmia e **EB** lidhur me udhëheqjen e **OI**. Këto dështime kanë çuar në vërtetim të gabuar të fakteve.

Më tej, Gjykata Themelore dha një mendim të përgjithshëm dhe të paqartë të “rregullit pa prova” lidhur me të gjitha provat shkresore. Këto prova shkresore përfshijnë, për shembull, letra rekomandimi nga një anëtar i Policisë Civile Napolitane të OKB-së dhe nga Shefi i Zyrës Rajonale për Kosovën Veriore Galluci, besueshmëria e të cilave nuk është në dyshim pasi ato janë dhënë nga mbrojtja e **OI**. Ato gjithashtu përfshinin botime gazetash që u vërtetuan në mënyrë të ndërsjellë, si dhe pjesërisht nga dëshmitë e dëshmitarëve, si dhe dokumentet që vinin nga organizata ndërkombëtare si UNMIK dhe Misionit Mbikëqyrës i Komunitetit Europian,

vërtetësia e të cilave nuk u kontestua nga mbrojtja. Këto dështime, përsëri, çuan në vërtetimin e gabuar të fakteve.

Prokurori e gjen befasuese se si Gjykata Themelore në të njëjtin Aktgjykim në fillim e gjen **OI** fajtor për krime të luftës kundër popullatës etnike shqiptare, dhe pastaj thotë se qëllimi i tij ishte të ndihmonte shqiptarët. Të paktën, Prokurori priste një shpjegim nga Gjykata Themelore.

Provat e reja

Prokuroria paraqet si provë të re artikullin X. Në këtë artikull **OI** shpreh udhëheqjen e tij mbi Rojeve të Urës

Përfundim

Prokurori arrin në përfundimin se nuk ka vlerësim të duhur të provave lidhur me Akuzën 2, pasi çdo provë u shqyrtua vetëm individualisht. Kështu që Gjykata Themelore nuk arriti të formojë një kuptim të plotë të gjendjes. Një vlerësim i duhur i provave në shpie mënyrë të pashmangshme në përfundimin se Rojeve të Urës ishin një organizatë e mirë-organizuar e udhëhequr nga **OI**.

Lidhur me çështjet e nxitjes dhe bashkëpunimit, Prokurori fillon duke vënë në dukje se dhuna etnike në Mitrovicë nuk u ndal, kur lufta kishte përfunduar zyrtarisht, dhe se ngacmimi dhe frikësimi ndodhnin çdo ditë në këtë qytet të ndarë në mënyrë efektive. Komuniteti serb e perceptonte lumin Ibër si “vija e fundit e mbrojtjes” dhe për të pasur sukses ishte e nevojshme të organizohej mbrojtja e urës.

Planifikimi

Prokurori mendon se veprat penale të përshkruara në Akuzën 2 nuk ishin thjesht hakmarrje për shpërthimin. Gjykata Themelore e ka cituar Dëshmitarin Y jashtë kontekstit dhe e ka interpretuar deklaratën e tij gabimisht. Pati shumë prova që mbështetnin planifikimin e sulmeve, për shembull: shënimi i **DD** se Dëshmitari Y arriti vonë në vendin e ngjarjes; numri i objektivave; zgjedhja vetëm e shqiptarëve etnikë si objektiva; kohëzgjatja e sulmeve; vendosmëria e sulmuesve; përdorimi i mitralozave dhe granatave të dorës. Kështu, Gjykata Themelore ka dështuar t'i vlerësojë provat me saktësi, dhe ky gabim ka çuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

Nxitja

Aktgjykimi nuk e diskuton aspak nxitjen nga **OI** ose **DD**, edhe pse ky është një pretendim qendror i Aktakuzës. Për këtë arsye ajo e ka përcaktuar gjendjen faktike në mënyrë jo të plotë.

Nxitja nga DD

Prokurori kujton se “nxitja” është e kryer me të përfunduar akti i nxitjes, pa marrë parasysh nëse i nxituri e kryen veprën apo jo. Së dyti, Prokurori vë në dukje se Gjykata Themelore gaboi kur vlerësoi se nuk ka prova vërtetuese për deklaratat e Dëshmitarit X, siç kërkohet nga neni 262 (3) i KPP-së. Deklaratat e dëshmitarëve X dhe Y ishin të besueshme dhe vërtetonin njëra-tjetrën. Më tej, deklarata e **H** është plotësisht në përputhje me faktet e përshkruara nga dëshmitarët X dhe Y. Gjithashtu, **D** dhe **S** e vënë veten aty ku Dëshmitari X tha se ishin. Prandaj deklarata e Dëshmitarit X nuk ishte prova e vetme apo vendimtare. Së treti, Prokurori pohon se e drejta e

marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë nuk është detyrim. Meqenëse mbrojtësi i **D** u thirr me rregull dhe kështu iu dha mundësia të merrte në pyetje dëshmitarin **N A**, Gjykata Themelore gaboi kur i vendosi vetëm vlerë të kufizuar provuese dëshmisë së tij.

Nxitja nga **DD** mund të përbëhet nga faktet në vijim: ai ishte i rrethuar nga anëtarë të MPB-së dhe me të u bashkuan edhe nga disa Rojeve të Urës; ai i drejtua atyre duke thënë se zona duhet të spastrohet nga shqiptarët; ai i kujtoi një anëtar të këtij grupi lidhur me “punën” e tij; fjalët e tij shkaktuan veprat penale, menjëherë dhe pa u vënë në pikëpyetje; meqenëse nuk u kërkua asnjë sqarim, duhet të ketë pasur një “plan të përbashkët”; prania edhe e një familjeje shqiptare në një ndërtesë e nxiti **DD** të urdhëronte “Shkoni dhe kryejeni këtë punë”; ndërsa negocioni me Policinë e UNMIK-ut lidhur me evakuimin e **DD, GD** ishte në krye të një grupi; dhe vetë **DD** pranoi se ekzistonte një strukturë komanduese hierarkike.

Prandaj, trupi gjykues e përcaktoi gabimisht faktin se **DD** nuk i nxiti ngjarjet e 3 shkurtit të vitit 2000.

*Nxitja nga **OI***

Prokurori pohon se në kundërshtim me gjetjet e Gjykatës Themelore, **OI** ishte në ndërtesë që nga fillimi i sulmit dhe kohë para ardhjes së KFOR-it. Prokurori më tej pohon se qëllimi i **I** nuk ishte të qetësonte situatën. Kjo provohet për shembull nga këto fakte: **OI** jepte udhëzime; **OI** në korridor mbante veshur jaknen karakteristike të Rojeve të Urës, dhe dikush e quajti atë “**O**”; **BR** iu drejtua **OI** përmes një pajisjeje komunikimi sikur ai të ishte udhëheqës i grupit; **I** përpara ndërtesës mori pjesë në mënyrë aktive në grup dhe grupi këshillohej me të, megjithatë ai nuk bëri asgjë për të parandaluar aktivitetet kriminale; **OI** u përfshi në negociata lidhur me një serb të ri, i cili mbahej nga barrikada shqiptare; dhe përfshirja e **OI** në grabitjen e banesës së dëshmitarit **HR**. Gjithashtu, Gjykata Themelore keqkuptoi dëshminë e **MH**. Ajo nuk i mohoi deklaratat që dha në hetim në procedurën paraprake. Përkundrazi, ajo deklaroi se qëndron pranë këtyre deklaratave. Megjithatë, në shqyrtimin gjyqësor ajo nuk mbante mend, dhe ishte gjithashtu qartazi në ankth për të dhënë deklaratë. Gjykata Themelore i ka shpërfillur plotësisht disa deklaratat të dëshmitarëve, dhe gjithashtu nuk bashkëlidhi deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, dhe kështu t’i vlerësonte provat në mënyrën e duhur. Kjo nga ana e vet çoi në vërtetimin e gabuar të përshkrimit faktik.

Bashkëkryerja

Për të filluar me Prokurorin vëren se aktgjykimi nuk ka diskutuar çështjen e bashkëkryerjes mes MPB-së dhe Rojeve të Urës. Të dy dëshmitarët X dhe Y theksojnë se ky bashkëpunim është një fakt i njohur gjerësisht. Ata japin shembuj të këtij bashkëpunimi, të tilla si: detyra të përbashkëta për të mbrojtur urën; taktika të koordinuara; prania e të dyve **OI** dhe **DD** gjatë përleshjeve të dhunshme; leja e MPB-së të përdorin objektet e Rojeve të Urës; bashkë veprimi i specifikuar i **OI** dhe **DD**; **OI** dhe **DD** të dy të veshur me xhaketa karakteristike për Rojeve të Urës; sulmet e grupeve të përziera në mbrëmje të përshkruar në aktakuzë; dhe përfundimi logjik se aktivitetet e përbashkëta të dy institucioneve të mirë-krijuara kërkon bashkëpunimin e udhëheqësve të tyre. Më tej, deklaratat paraprake e Dëshmitarit X ofron informacion shtesë, të tilla si shpërndarja e detyrave dhe zinxhirit komandues të Rojeve të Urës, dhe miqësisë mes **OI** dhe **DD**. Megjithatë, Gjykata nuk arriti të përball atë lidhur me këto lëshime. Gjithsej Gjykata Themelore ka dështuar

të merr në konsideratë provat në mënyrë të plotë dhe me hollësi, e cila ka çuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

Së fundi, Prokuroria thekson se deklarata e **DG** në dëbimin e saj është dëshmi konfirmuese siç sqaron gjendjen e përgjithshme, dhe si e tillë nuk duhet të përjashtohet.

Konkluzion

Për të përmbledhur, Prokuroria vë në dukje se të gjitha lëshimet e përmendura më sipër dhe vlerësimet e gabuara kanë çuar në një shfaqësim të rreme.

Në lidhje me pikën 3:

- Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 383 (1.1) në lidhje me nenin 384 (2.1) të KPP-së;
- Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 383 (1.3) në lidhje me nenin 386 (3) të KPP-së.

Në lidhje me Pikën 3 prokurori propozon për të ndryshuar aktgjykimin duke dënuar **NV**, **IV** dhe **AL** si të akuzuar në aktakuzë.

Në lidhje me Pikën 3 Prokurori vë në dukje se është e qartë se qëllimi i sulmit kundër familjes **A** ishte për të asgjësuar **NA**, i cili kishte punuar për Sigurimin shtetëror serb. Kjo zhvillohet si në vijim: kohëzgjatjen dhe vrullin e sulmit që përfundoi vetëm pasi KFOR-i ndërhyri, si dhe viktimave konkrete.

Prokurori thekson se Gjykata Themelore, si rregull i përgjithshëm, nuk i ka besuar një deklaratë të një dëshmitari që nuk është vërtetuar. Kjo metodë e vlerësimit nuk është e bazuar në kodin e procedurës penale, dhe është me të meta.

Prokurori mendon se **VA** ka dhënë një deklaratë të qetë, të fortë dhe të strukturuar. Dëshmia e saj e vë **NV** dhe **AL** në vendin e krimit. Ajo gjithashtu tregon për habinë e babait të saj **NA**, kur ai e kuptoi se fqinjët e tij **IV**, **NV** dhe **AL** ishin në mesin e sulmuesve. Prania e **NV** në vendin e krimit u konfirmua gjithashtu edhe nga dëshmitarja **RA**. Gjithashtu ajo dëgjoi babain e saj **NA** duke folur për “**I**”, “**N**” dhe “**S**”. **VA** më tej tregon për hedhjen e granatave të dorës në banesën e saj - një fakt i cili është vërtetuar nga dëshmitarët e tjerë. Gjithashtu, dëshmitari **GX** thotë se **NA** kishte kërkuar ndihmë nga **IV**, duke e vendosur atë në vendin e krimit.

Kur dështimi për të përcaktuar fajin e **IV**, **NV** dhe **AL** Gjykata Themelore ka dështuar që në mënyrë të qartë dhe me hollësi të vlerësojë provat, duke çuar kështu në një vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.

Përgjigjet në ankesën e Prokurorit

Avokatët mbrojtës të të akuzuarit, **OI**, avokatët Nebojša Vlajić dhe Ljubomir Pantović paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorit. Ata i referohen ankesën e tyre dhe japin mendimin më tej se ankesa e Prokurorit nuk përmban argumente për të konfirmuar meritat e veta. Ata pretendojnë se

akuzat e papranueshme janë të bazuara në interpretimin e gabuar të aktgjykimit, vlerësim të pjesshëm dhe jashtë-kontekstit të Aktgjykimit, dhe duke theksuar të dhënave të pasakta.

Në lidhje me përcaktimin e përshkrimit faktik të Pikës 1, që më saktësisht theksojnë se para së gjithash **OI** nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit. Së dyti, prokurori i bazon akuzat e tij për pozitën e autoritetit mbi paramilitarët/policinë në vetëm dy fjali – “Përse më pyet mua? Ndiqni urdhërat e dhëna.” Më tej, në mënyrë shtrenbëruese Prokurori flet për urdhërat në shumës, edhe pse ai vetëm identifikon dy fjali të lartpërmendura. Për më tepër, ankesa është e bazuar në konkluzionet e veta të Prokurorit të cilat nuk janë të mbështetura me dëshmi, të tilla si struktura e fortë organizative përgjithësisht e njohur të paramilitarëve serb, dhe rolin e **OI** si një udhëheqës. Gjithashtu, prokurori ka dështuar të sqarojë dilemën që trupat nuk janë gjetur aty ku dëshmitari **M** tha se ata u vranë. Së fundi, Prokurori plotësisht të harruar vlerësimin e pyetjes së pretenduar të **OI** “Përse më pyet mua?”

Në lidhje me përcaktimin e përshkrimit faktik të Pikës 2, avokatët mbrojtës të **OI** më konkretisht thonë se Prokurori tregoi njëanshmëri kur etiketoi dëshmitarët e mbrojtjes si nacionalistët serbë, dhe ka pranuar gënjeshtër dhe dukshme të dëshmitarëve të Prokurorisë. Më tej, dëshmitari **BR** ka deklaruar se duke punuar si Kryeministër i Kosovës ose si Ministër i Punëve të Brendshme se nuk kishte dëgjuar për **OI** si lider i Rojeve të Urës, edhe pse gjatë dëshmisë së tij ai dha shumë informata në lidhje me organizatën në fjalë. Gjithashtu, Prokurori lë të kuptohet, por nuk japë asnjë dëshmi, të frikësimit të Dëshmitarit X. Kur është dëgjuar Dëshmitari X, Gjykata Themelore ka ndjekur procedurën saktë, madje edhe kur ajo nuk i ka dhënë Prokurorit të drejtën për të rimmarr në pyetje dëshmitarin. Prokurori nuk është në përputhje gjatë vlerësimit të dëshmitarëve. Ai paraqet disa deklarata të dëshmitarit **SH** si provë dhe të tjerë ai i injoron. Dëshmitari **EB** dhe zyrtarët ndërkombëtarë kanë marrë të njëjtin trajtim. Gjithashtu, prokurori e ka keqkuptuar plotësisht qëllimin e Rojeve të Urës - kjo ishte për të ndaluar UÇK-në për të hyrë në Mitrovicën e Veriut. Së fundi, pasi Gjykata Themelore ka konkluduar me të drejtë, dëshmitarët **IM, SH, IR, SA** dhe **VA** nuk janë dëshmitarë të besueshëm.

Mbrojtja mendon se Prokurori ka shkelur detyrimin e tij për të gjetur të vërtetën materiale pasi që qëllimi i tij i vetëm duket të jetë për të dënuar **OI**.

Sa i përket dënimit, mbrojtja vë në dukje se disa nga shembujt e dënimit të paraqitura nga Prokurori nuk ishin vendime të prera dhe janë përmbysur - të tilla si 12 vjet për shkatërrimin e pronës, etj, dhe 12 dhe 10 vjet për përdhunim. Bazuar në këto gjetje mbrojtja po ashtu vë në dyshim vlefshmërinë e shembujve të tjerë të dhënë nga Prokurori. Më tej, mbrojtja gjen pretendimet e Prokurorit në rrethana rënduese krejtësisht të papranueshme dhe pa asnjë dëshmi për ti mbështetur ato.

Së fundi, mbrojtja kundërshton provat shtesë të propozuar nga Prokurori pasi që ato nuk kanë vlerë dëshmuuese.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit **DD**, avokati Miodrag Brkljač, ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorit të datës 6 maj 2016. Ai e konsideron ankesën e prokurorit si të pabazuar dhe propozon që të refuzojë atë. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore duhet të konfirmohet.

Sa për “planifikimin e sulmeve”, mbrojtja mendon se Gjykata Themelore arriti në përfundimin e duhur, dmth se sulmi nuk ishte i planifikuar. Mbrojtja i referohet argumenteve e saj përmbyllëse në Gjykatën Themelore. Ai më tej thotë se pas një shqyrtimi të hollësishëm, Gjykata Themelore ka arritur në përfundimin e saktë, dmth se sulmet ishin një përgjigje spontane për sulmin ndaj të rinjve serbë në kafenen BA (BA). Mbrojtja vë në dukje se është e palogjikshme që Dëshmitari Y, i cili është një udhëheqës i një nga “grupet luftarake” dhe ishte shpesh në shoqërinë e **DD**, nuk ka pasur ndonjë informacion paraprak në lidhje me sulmin. Gjithashtu, jo vetëm që ishte S K nuk ishte dërguar për të marr Dëshmitarin Y, por ai nuk ishte as në qytet atë mbrëmje. Më tej, mbrojtja argumenton se si sulmi në kafenenë BA (BA) nuk ishte planifikuar dhe zuri të gjithë në befasi, ashtu që a ka mundur që “kundër-sulmi” mos të jetë planifikuar. Lidhur me listën e pretenduar të caqeve, mbrojtja vë në dukje se në njërën anë ka pasur shumë shqiptarë që jetonin në zonën që nuk ishin në shënjestër. Së fundi, mbrojtja vë në dukje se në qoftë se ka pasur “një plan të përbashkët”, atëherë autorët e vërtet të krimit duhet të ishin gjetur deri tani.

Sa i përket nxitjes nga **DD** mbrojtja mendon se sulmi në hyrje të Rrugës X nuk ka ndodhur dhe se Dëshmitari X duhet të ketë gënjyer. Nëse do të kishte ndodh një sulm i tillë, ai me siguri do të kishte qenë i përfshirë në aktakuzë. Për më tepër, në kundërshtim me deklaratat e prokurorit, pretendimet e Dëshmitarit X nuk janë në përputhje me deklaratat e Dëshmitarit Y, SH , RŠ apo **DD**. Gjithashtu, mbrojtja vë në dukje se edhe pse bindja e vartësve në një organizatë është e zakonshme, është e njohur gjithashtu se një urdhër për të kryer një krim të rëndë nuk do të zbatohen por i referohet një eprori. Mbrojtja po ashtu mendon se deklarata e **DD** për vartësit e tij duke u kthyer në tavernë me të kur ai e urdhëron kështu, dëshmon se ai ishte në fakt në këtë tavernë, dhe jo në vendin e krimit. Për më tepër, Gjykata Themelore në mënyrë të qartë dhe bindshëm e kishte arsyetuar besueshmërinë e dëshmitarit **NA**. Në thelb, dëshmia e tij nuk korrespondon me deklaratat e dëshmitarëve të besueshëm **GX** dhe **SA**. Gjithashtu, dëshira për hakmarrje e dëshmitarëve **VA** dhe burrit të saj **SA** ishte e qartë.

Mbrojtja thekson dështimet në afatet kohore të supozuara. Si sulmin ndaj kafenes **BA (BA)** padiskutueshëm u zhvillua rreth orës 20.20, koha e ngjarjes që u tha nga Dëshmitari X nuk përputhet. Gjithashtu, pohimi nga Prokurori që **DD** shkurtimisht është larguar nga taverna nuk përputhet me afatet e përcaktuara. Gjithashtu, **H** nuk mund të ketë parë **DD** duke negociuar me UNMIK-un në lidhje me dëbimin e **DG** rreth orës 18.00, pasi shpërthimi nuk ka ndodhur ende. Aq më tepër, dëshmitari **H** nuk ka mundur nga banesa e tij të ketë parë negociatat fare nëse ato kanë ndodhur aty ku ai tha.

Sa i përket bashkëkryerjes që pretendohet mbrojtja i referohet fjalës së saj përmbyllëse. Ai më tej thekson se Këshilli Kombëtar Serb ka kundërshtuar autoritetet zyrtare, dhe në këtë mënyrë nuk kanë mundur të bashkëpunojnë. Më konkretisht, **DD** iu ishte urdhëruar që të distancohet nga **OI**, dhe dëshmitari Y konfirmon këtë “ftohje të marrëdhënieve”. Mbrojtja pohon se mbrojtja e urës ishte një veprim spontan, i gjerë popullor dhe legjitim. Së fundi, mbrojtja pohon se 7 ose 8 ish-zyrtar të policisë nuk mund të formojnë “një institucion” ose kryen ndonjë detyrë policore

Për të përmbledhur, Gjykata Themelore nuk ka shkelur në mënyrë esenciale dispozitat e procedurës penale. Ajo ka përcaktuar gjendjen faktike në bazë të vlerësimit të plotë dhe të duhur të provave të administruara. Dhe ka zbatuar të drejtën materiale si duhet.

NV personalisht ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorit të datës 27 prill 2016. Ai kërkon që ankesa e Prokurorit të refuzohet dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të konfirmohet.

Së pari, **NV** thotë se ai nuk është një avokat, dhe se ai u lirua nga arresti shtëpiak më 5 gusht 2015.

Ai pohon se prokurori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të re dhe mendon se Prokuroria nuk ka bazë për ankesë. Gjykata Themelore e ka vlerësuar si duhet deklaratën e dëshmitarit **VA** si të përshtatura për të përmbushur provat e burrit të saj, dhe në kundërshtim me të tjerat, dëshmi të besueshme. Aj, për shembull, gabimisht tha se: **GX** mbërriti në banesën e **NA** në ora 20.00; njerëzit filluan të mbledhen jashtë ndërtesës S-3 tashmë në ora 20.00; Emri i **NV** është **NI**; **NV** ishte i veshur me rroba të errëta; dhe se **VA** e nje **NV**. Ajo ka deklaruar saktë se ajo ose dikush tjetër nuk e ka parë bombat duke u hedhur .

Gjithashtu, Gjykata Themelore ka vlerësuar si duhet deklaratën e dëshmitarit **SA** si jo të besueshme. Për shembull, ai: ngatërroi plotësisht identifikimin e **NV**; rrejshëm pohoi se ata e njihnin njëri-tjetrin; ka ndryshuar dëshminë e tij nga një ditë në tjetrën; dhe kundër logjikës deklaroi se **NV** ishte me uniformë dhe i armatosur plotësisht, edhe pse kjo do të ishte e pamundur për shkak të kontroleve të UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Asnjë nga dëshmitarët e prokurorisë **GX, RA, SA** - që Gjykata Themelore i konsideronte të besueshme - ose **AA** kanë përmendur detaje që lidhin **NV** me sulmin. Në të kundërtën, **RA** dëshmoi se ajo ose babai i saj **NA** nuk e ka parë **NV** në vendin e krimit. Në mënyrë të ngjashme, **SA** ka deklaruar se ajo ose burri i saj nuk e ka parë **N V** në vendin e krimit. Gjithashtu, **G Xh** thotë se ai nuk e ka parë **NV** në vendin e krimit e as **S** e as **N** nuk kanë njohur ndonjë nga sulmuesit. Sipas **GX, N** kishte kërkuar vetëm ndihmën e fqinjëve të tij. As dëshmitarët **X** dhe **Y** - të cilët janë gjithashtu konsideruar të besueshëm nga Gjykata Themelore - shih **NV** marrja pjesë në aktivitete kriminale. Së fundi, nuk ka prova që lidhin **NV** me Rojet e Urës .

Dëshmitari **MT** si dhe i pandehuri **NV** dëshmuan se **NA** dhe babai i tij **M** ishin të emëruar se fqinjët e tij nuk e kanë ndihmuar atë. Ata nuk kanë foluar për pjesëmarrjen e **NV** . Sipas **NV** babai i tij **IV** foli për të njëjtën gjë. Dëshmitari **ID** flet për diskutime të ngjashme me **MA** .

NV pranon vlerësimin e Gjykatës Themelore se do të ishte e palogjikshme që ai të sulmojë banesën afër banesës së familjes së tij dhe kështu duke vënë familjen e vet në rrezik. Në fakt **NV** dhe babai i tij nuk kanë mundur të arrijnë në banesë deri sa erdhi policia e UNMIK-ut, por ata është dashur të qëndrojnë dhe të presin në rrugë.

Për të përmbledhur, **NV** mendon se Gjykata Themelore ka vlerësuar provat në mënyrë të qartë dhe të hollësishme.

Së fundi, **NV** vë në dukje se një procedurë penale tashmë është kryer në këtë rast, respektivisht Hep.nr.139/02. Në këtë procedurë Gjykata e Qarkut lëshoi një Aktvendim për refuzimin e kërkesës për fillimin e hetimeve kundër **NV**. Ky aktvendim ka marrë formë të prerë. Nuk ka kërkesa për rigjykim, e as nuk janë paraqitur provat e reja.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit **NV**, avokati Zarko M. Gajic, ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorit të datës 26 prill 2016. Ai kërkon që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazë dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të konfirmohet.

Avokati mbrojtës pohon se pretendimet e prokurorit nuk qëndrojnë. Dëshmitari **SA** nuk e ka thënë të vërtetën në procedurë. Kështu, pretendimet e bëra nga Prokurori në bazë të deklaratave të tij nuk mund të pranohet. Gjithashtu dëshmitarja **VA** është një dëshmitare e pabesueshme. Ajo është dëgjuar në disa raste dhe ka dhënë deklaratat kontradiktore. Për më tepër, pohimi i Prokurorisë se pjesë të deklaratave të saj janë konfirmuar nga dëshmitarët e tjerë nuk qëndron.

Gjithashtu, Prokurori ka neglizhuar dëshmitë e **DK** dhe **ID**, të cilët konfirmojnë plotësisht deklaratat e **NV**. Për më tepër, deklaratat e dhëna nga **GX, RA, SA** dhe **AA** nuk e konfirmojnë përfshirjen e **NV** në aktivitete kriminale. As dëshmitarja **EX** nuk ka parë **NV** ose **IV** duke marrë pjesë në aktivitete kriminale.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit **IV**, avokati **DL**, ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorit të datës 26 prill 2016. Ai kërkon që ankesa e Prokurorit refuzohet si e pabazë dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të mbetet në fuqi.

Së pari, dëshmitari **SA** nuk është i besueshëm. Deklaratat e tij ndryshuan nga një seancë në tjetrën, dhe disa nga deklaratat e tij ishin kundër kuptimit apo logjike, ose provave të tjera ose faktet në shkresat e lëndës. Së dyti, **VA** nuk është e besueshme. Deklaratat e saj nuk janë as konfirmuar pjesërisht nga dëshmitarët e tjerë. Së treti, dëshmitarët **GX, RA, SA** dhe **AA** nuk mund të konfirmonin se **IV** ishte i përfshirë në sulm.

Siç ka theksuar Gjykata Themelore, do të ishte e palogjikshme që **IV** do të sulmonte banesën pran asaj të vetes, duke rrezikuar kështu të afërmit e tij të ngushtë. Në përputhje me këtë vlerësim dëshmitari **DK** dhe **ID** kanë konfirmuar deklaratën e **IV** se ai ka pritur para banesës deri sa hyrja në ndërtesë është zhbllokuar.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit **AL**, avokat Dobrica Lazić, ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorit Publik të datës 4 maj 2016. Ai kërkon që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazë dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të konfirmohet.

Mbrojtja konteston pohimet e Prokurorit në tërësinë e tyre. Gjykata Themelore me vëmendje të mjaftueshme si dhe me vlerësim të plotë dhe delikat të provave të paraqitura, veç e veç dhe në lidhje me provat e tjera, me kujdes dhe tërësisht ka vlerësuar provat.

Aktakuza është e bazuar në disa supozime të gabuara, të tilla si: **AL** ishte anëtar i; Rojet e Urës ishte një organizatë e strukturuar me **OI** si udhëheqësin e saj; Rojet e Urës ishte një grup me qëllim të keq që ka kryer krime; se ka pasur një lloj plani të përbashkët për sulmet në 3 shkurt 2000; dhe se alibia e **AL** do të lejonte veprimet e pretenduara nga prokurori.

Dëshmia e **SA** nuk ishte e vërtetë. Dëshmitarja **VA** nuk e lidhë **AL** me ndonjë veprimtari kriminale - përkundrazi. E njëjta gjë vlen edhe për dëshmitarin e mbrojtur. Mbrojtja mendon se asnjë me origjinë nga Mitrovica e Veriut, i cili e njihje **NA**, do të kishte zgjedhur atë si një cakë. Dëshmitari **Xh** dëshmoi të vërtetën. Më tej, mbrojtja mendon si qesharake pretendimin e dikujt duke hedhur një bombë në një banesë më lart, pasi kjo është e pamundur. Gjithashtu, dëmet e pretenduara të shkaktuar nga kjo bombë nuk janë realiste.

Për të përmbledhur, Gjykata Themelore ka arritur saktë të vërtetën materiale, përkatësisht vendimi se akuzat nuk janë provuara.

III. ANKESAT E I DHE PËRGJIGJE PËR TO

OI personalisht më 18 prill 2016 me kohë ka paraqitur ankesë në të njëjtën ditë në Gjykatën Themelore në bazë të:

- shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- shkelje esenciale të kodit penal;
- vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike; dhe
- vërtetimit të gabuar të sanksioneve penale.

OI kërkon që aktgjykimi i Gjykatës Themelore të ndryshohet dhe ai të lirohet. Nga ana tjetër, **OI** kërkon që aktgjykimi të anulohet në lidhje me Pikën 1 dhe të dërgohet për rigjykim. Në çdo rast, **OI** gjen dënimin e tepërt dhe kërkon ti shqiptohet një dënim më i butë.

OI insiston se ai nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit, e në asnjë mënyrë nuk ka marr pjesë, të kontribuojë ose të pajtohet me atë që ndodhi në vitin 1999.

OI mendon se Gjykata Themelore ka përcaktuar elementin subjektiv të veprës penale në mënyrë të gabuar në bazë të kriterit objektiv të përkatësisë dhe “njohurisë kolektive”. Elementi subjektiv - vullneti i kryesit të veçantë - është një kërkesë thelbësore në doktrinën e përgjegjësisë individuale në të drejtën penale. E kundërta - përgjegjësia strikte në bazë të anëtarësimit - nuk ekzistonte në Jugosllavi. Gjykata Themelore nuk ka dhënë arsyetim se si ajo arriti në përfundimin se **OI** ishte në dijeni të këtij “plani kolektiv” të supozuar ose pranimit të tij. Kështu, **OI** nuk mund të mbahen përgjegjës për veprimet impulsive që çojnë të tjerët të kryejnë vepra më të rënda penale.

Në kundërshtim me atë që Gjykata Themelore ka konkluduar², **OI** nuk ishte në dijeni të “planit kolektiv” të pretenduar dhe kështu nuk i ka parashikuar pasojat. “Plani kolektiv” i supozuar

² Aktgjykimi, paragrafi 302

nuk përfshin privimin e jetës si mund të shihet nga veprimet e ushtarit që ka ndaluar të shtënat. Më së shumti, “Plani kolektiv” i supozuar ishte për deportimin e civilëve në Shqipëri, si mund të nxirret nga urdhërat e shumta të dhëna nga ushtarët, policët dhe paramilitarët ndaj shqiptarëve etnik. Gjithsesi, veprimet e **OI** ishin jashtë fushëveprimit të këtij “plani kolektiv” të supozuar.

Neni 142 të KPRSFJ-së kërkon ose kryerjen e menjëhershme të veprës ose duke i dhënë urdhra për të kryer veprën penale. Gjykata Themelore ka deklaruar në mënyrë të qartë se **OI** nuk ishte nxitës. Gjykata Themelore nuk ka specifikuar veprimet e drejtpërdrejta inkrimuese individuale të **OI**. Veprimet e **OI** që janë gjetur të provuar nga Gjykata Themelore³ nuk përbëjnë kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale.

Gjykata Themelore ka gabuar në përcaktimin e bashkëkryerjes. **OI** nuk ishte në dijeni të “planit kolektiv” të pretenduar as nuk bien dakord me të apo qëllimet e saj. Më tej, **OI** nuk ka *ex ante* të konsiderueshme të kontribuojë në kryerjen e veprës penale apo veprimet e tij nuk ishin të lidhura me veprimet e autorëve e as veprimet e tij kanë plotësuar ato të autorëve. Kështu, gjendja objektive e përgjegjesisë penale nuk është përbushur. Gjithashtu, konstrukti gjyqësor i “ndërmarrjes të përbashkët kriminale”, nuk është i njohur në Kosovë. Mungesa e planit të përbashkët, qëllimi dhe njohja e pasojave janë diskutuar më sipër. Parakushtet tjera të bashkëkryerjes, domethënë një rol të veçantë dhe aftësinë për të parandaluar veprën penale, nuk janë përbushur në lidhje me **OI**. Në të kundërtën, komenti i supozuar i **OI** shprehi habi se ai u pyet për udhëzime.

Aktgjykimit i mungon arsyetimi i saktë për mënyrën se si veprat e **OI** ka qenë provuar për të kryer për të përbushur veprën penale siç është përshkruar në aktakuzë. Më tej, Aktgjykimit i mungon arsyetimi i mjaftueshëm se si Gjykata Themelore ka dhënë përfundimin se **OI** ishte i vetëdijshëm për “planin e përbashkët” të pretenduar për të vrarë shqiptarët. Në vend të kësaj, Gjykata kundërshton veten duke thënë se vrasësit mund të kenë tejkaluar urdhrat fillestare.⁴ **OI** mendon se bashkë-kryerja nuk mund të konkludohet nga dy fjali që ai gjoja ka folur. Në të kundërtën, duke i kërkuar një profesionisti për të ndjekur rregullat nuk mund të supozohet që të çojë në paligjshmëri.

OI pohon se ligjet e zbatueshme në Kosovë nuk e njohin konceptin e “qëllimit të tërthortë”, dhe madje edhe në qoftë se e bënë, qëllimi i tërthortë i **OI** nuk është vërtetuar nga ana e Gjykatës Themelore.

Aktgjykimi duhet të jetë i qartë, specifik dhe konciz. Më tej, aktgjykimi me shkrim duhet të korrespondojnë me klauzolën e dispozitivit të shpallur publikisht. Dështimi i Gjykatës Themelore për të bërë kështu rezulton në shkelje të kodit të procedurës.

Neni 3 i Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës përcakton se “Asgjë në këtë protokoll do të thirret për qëllim që të ndikojë në sovranitetin e një shteti ose përgjegjësinë e qeverisë, me të gjitha mjetet legjitime, për të mbajtur ose rivendosur ligjin dhe rendin në shtetin ose për të mbrojtur unitetin kombëtar dhe integritetin territorial të shtetit.” Kështu **OI** mendon se zbatimi i këtij Protokollit në këtë rast është kontestuese, pasi që të ashtuquajturat “forcat serbe” ishin

³ Aktgjykimi, Faqet 7 – 8

⁴ Aktgjykimi, paragrafi 226

thjesht duke u përpjekur për të rivendosur dhe mbajtur ligjin dhe rendin dhe të mbrojë integritetin territorial përmes mjeteve juridike.

Gjykata Themelore ka shkelur parimin *in dubio pro reo*, kur ajo nuk ka, kur në dyshim, konsideruar faktet që përfiton i pandehuri si të provuar, dhe vendos një nivel më të lartë të provës për faktet në dëm të të pandehurit. Të drejtat e **OI** gjithashtu janë shkelur kur atij nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes ose ankesën e tij, dhe kjo ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Gjithashtu, dhënia e disa dëshmitarëve statusin e dëshmitarëve të mbrojtur ka zvogëluar edhe më tej mundësin e **OI** për të mbrojtur veten.

Më tej, një inspektim vend të ngjarjes është kryer në 15 prill të vitit 1999 nga gjykatësi **M** dhe një procesverbal u përpilua nga skena e vrasjes në atë kohë. Ky procesverbal është përpiluar në mënyrë të rregullt nga organet hetimore të ligjshme në atë kohë. Prokuroria nuk ka ofruar prova të reja siç kërkohet me ligj, pasi që hetimi ka pushuar më parë.

Gjykata Themelore ka qenë e njëanshme kur ka përcaktuar “pasqyrën e përgjithshme” të situatës në 1999, siç mund të shihet nga pranimi i saj selektiv të deklaratave të dëshmitarëve. Për më tepër, vlerësimi i provave ishte me të meta për shkak të refuzimit të Gjykatës Themelore për të lejuar pyetje sugjestive nga prokurori dhe nga refuzimi i Gjykatës për të pranuar se ngjarjet traumatike ndikojnë në perceptimin dhe kujtesën e dëshmitarëve dhe kjo ul besueshmërinë e tyre dëshmuese.

Gjykata nuk ka qenë në gjendje për të kuptuar aktorë të ndryshëm në kohë, por në mënyrë të gabuar përdor termat paraushtarake/polici. Kështu, një fakt i rëndësishëm nuk është përcaktuar, as besueshmëria e dëshmitarëve nuk është vënë në pyetje, kur ata nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë dallimin në mes të dy. Më tej, Gjykata Themelore nuk ka përcaktuar se çfarë do të thotë se paraushtarakët kanë “marrë përsipër” individët, nuk ka shpjeguar se si është konstatuar se individët janë sulmuar fizikisht, apo pse konsiderohet e nevojshme për të përcaktuar kriteret sipas të cilave janë përzgjedhur nëntë individë të vriten, ose të përshkruajë saktësisht se si janë shoqëruar individët. Gjithashtu, gjatë vlerësimit të besueshmërisë së deklaratave të dëshmitarëve Gjykata Themelore ka injoruar rëndësinë e deklaratave të shumë dëshmitarëve të cilët thanë se kishin folur me **IM** në lidhje me identitetin e **OI**. Së fundi, **OI** vlerëson dëshminë e **IM** si të palogjikshme, brenda kontradiktore dhe jo të besueshme, dhe dëshminë e **HB**, si krejtësisht të pabesueshëm. Kështu, Gjykata Themelore ka bazuar aktgjykimin e saj në prova jo të besueshme.

Kapaciteti mendor i **OI** në atë kohë nuk u përcaktua në gjyq. As nuk janë faktet e pretenduara se **OI** ishte “një personalitet i njohur”, se ai kishte një “karrierë të suksesshme në artet marciale”, apo se ai kishte “një shumëllojshmëri të ndërmarrjeve komerciale”. Në fakt, të gjithë dëshmitarët e kanë njohur atë vetëm pas luftës, kur **OI** u shfaq si një udhëheqës serb, dhe kur thashethemet filluan të qarkullojnë.

Avokati mbrojtës Nebojša Vlajić dhe Ljubomir Pantović në emër të **OI**, më 18 prill 2016 me kohë kanë paraqitur ankesë në të njëjtën ditë, në lidhje me Pikën 1, në Gjykatën Themelore në bazë të:

- vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike;

- shkelje esenciale të ligjit penal;
- shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përfshirë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; dhe
- vërtetimit të gabuar të sanksioneve penale.

Avokatët mbrojtës kërkojnë që aktgjykimi i Gjykatës Themelore të konfirmohet në lidhje me lirim. Për më tepër, avokatët mbrojtës kërkojnë që aktgjykimi të ndryshohet dhe **OI** të lirohet edhe nga Pika 1. Përndryshe, avokatët mbrojtës kërkojnë që Aktgjykimin të anulohet në lidhje me Pikën 1 dhe të dërgohet për rigjykim.

a) vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike

Avokatët mbrojtës mendojnë se prania e **OI** në vendin e krimit nuk është përcaktuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

IM është dëshmitari kryesor. Dëshmitë e tij të ndryshme janë në kundërshtim me njëra-tjetren, sidomos në vijim: në lidhje me atë që gjoja ka thënë **OI**; përkatësia e “shpëtimtarit”; ku shqiptarët etnik u urdhëruan për të shkuar; kush kishte veshur çka; nëse po ose jo **OI** kishte një Motorola në dorë; dhe a ishte **OI** ulur ose në këmbë kur ai vuri maskën e tij. Për më tepër, ndryshe nga **IM** deklaroi fillimisht, ai nuk e ka njohur **OI** para konfliktit. Gjithashtu, trupat nuk janë gjetur, aty ku **M** tha se ata u qëlluan. Ndërsa ai përgjigjet me supozime dhe trillime, kur ai nuk e di përgjigjen, ai nuk është një dëshmitar i besueshëm. Dëshmitari **SK** nuk e dinte se kush ishte **OI** para se **IM** i tha atij. Kështu njohja e tij e supozuar e **OI** në skenën e krimit është i pabesueshëm. Për më tepër, detajet e deklaratës **K** është në kundërshtim me ato të **M** -së. Dëshmitari **XS** nuk e konfirmon asnjë nga vëzhgimet e **IM**, edhe pse ai ishte i pranishëm në skenën e krimit si një nga palët e dëmtuara. Dëshmitari **MLI** a nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit. Më tej, ai pretendon se **OI** iu ka drejtuar atij në gjuhën serbe, edhe pse dihet se **OI** flet shqip. Ka pasur mospërputhje të mëtejshme në deklaratën e tij që është dashur të konsiderohen si jo të besueshme. Deklarata e dëshmitarit **KA** është në kundërshtim të thellë me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë në këtë mënyrë zvogëlojnë besueshmërinë e tyre. Dëshmitarët **BF** dhe **MM** nuk kanë konfirmuar asnjë nga vëzhgimet e **IM** edhe pse ata ishin të pranishëm në skenën e krimit si një nga palët e dëmtuara. E vetmja gjë e përbashkët është pohimi se **IM** përmendi **OI** atyre. Dëshmitari **LA**, i cili e njeh shumë mirë **OI**, nuk e ka parë atë ditë. Për më tepër, çeçet e tij të pensionit u vodhën nga zyrtarë serbë të cilët më vonë i kanë përdorur ato në Serbi. Dëshmitarja **C** është tërësisht i pabesueshëm pasi që ajo harron gjërat. Për më tepër, ajo është qartë e njëanshëm dhe e nxitur nga urrejtja. Gjithashtu, dëshmia e saj është në kundërshtim me dëshminë e saj të mëparshme në një rast tjetër, por për të njëjtën ngjarje. Dëshmitarja **FP** kujton për sigurt vetëm se **M** i tha asaj për **I**. Dëshmitari **QI** ka lënë Mitrovicën para ngjarjeve të përshkruara në aktakuzë. Për më tepër, dëshmia e tij është e diskredituar nga një deklaratë e cila ishte dëshmuar si e sajuar në procedurë gjyqësore. Kjo ishte përfshirja e një numër telefoni që nuk ka ekzistuar në kohën kur deklarata është dhënë. Dëshmia e dëshmitarit **ZA** nuk është e besueshme pasi ai mësoi identitetin e **I** shumë kohë pasi ai pohoi se e ka takuar atë. Kredibiliteti i tij është zvogëluar më tej nga fakti se ai nuk mund të mbante mend një datë të rëndësishme si kur ai u dëbua nga shtëpia e tij. Gjithashtu, ai pretendon se ka raportuar **OI** në polici, kur në fakt ai nuk e bëri. Gruaja e tij, deklarata e dëshmitarit **NA** -së qartë kundërshton pretendimet e tij. Dëshmitari **BS** ishte i pranishëm në vendin e krimit por nuk mund të thoshte asgjë në lidhje me ngjarjet.

Nuk ka prova që lidh **OI** me forcat serbe gjatë vitit 1999. Në të kundërtën, ai u ka ndihmuar njerëzve. Dëshmitarët **BI, BR, IR, SH, EB, AD** dhe të dy dëshmitarët e mbrojtur të gjithë dëshmojnë se **OI** ishte duke punuar në Ferronikel në vitin 1999. Kjo është konfirmuar nga ditari i **OI** dhe librezat e punës. Nuk ka të dhëna zyrtare të përfshirjes së tij as në ushtri apo polici në vitin 1999. Përgjigja e pretenduar e **OI**: “Pse më pyet mua?” gjithashtu reflekton mos-përfshirjen e tij ndaj palëve të konfliktit. Më tej, në qoftë se ai e ka udhëzuar një profesionist për të ndjekur rregullat, me siguri kjo do të referohen rregullave ligjore.

Prokurori ka qenë i mashtruar nga **IM** dëshmia e të cilit ka ndryshuar vazhdimisht. Të gjithë dëshmitarët e tjerë pajtohen se kanë folur me **IM** në lidhje **OI**, edhe pse në kohë të ndryshme.

Si askush nuk e pa ekzekutimin aktual dhe si trupat nuk janë gjetur aty ku dëshmitarët thanë se u vranë, nuk është vërtetuar se viktimat e emëruar vdiqën në vendin e përshkruar në aktakuzë.

Aktgjykimi nuk shpjegon se si janë vlerësuar provat. Nuk përmendet në lidhje me ndonjë provë ligjore apo ndonjë shpjegim se si Gjykata Themelore ka konsideruar prova kredibile dhe të besueshme, edhe kur dëshmitë kishin ndryshuar. Kjo do të ishte veçanërisht e rëndësishme pasi që kishte kaluar shumë kohë që nga ngjarjet kanë ndodhur. Gjykata Themelore ka treguar njëanshmëri duke gjetur rregullisht justifikim në dëm të të pandehurit. Kështu, Gjykata Themelore nuk ka vlerësuar besueshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarit si duhet.

b) Shkelje esenciale e ligjit penal

Gjykata Themelore ka shkelur parimin “*ne bis in idem*”, për shkak se çështja është gjykuar më parë nga Prokurori dhe UNMIK-u. Dëshmitarët e dëgjuar në procedurën e UNMIK-ut janë të njëjtë me ata që janë dëgjuar në këtë gjykim. Pasi që nuk ka prova të reja, kodi i procedurës penale nuk lejon rigjykimin.

Neni 22 të KPRSFJ-së mbi bashkëkryerjen, parasheh që bashkëkryerësi është personi i cili merr pjesë në aktin e kryerjes, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përbashkët e kryen veprën penale. Pasi që **OI**-i nuk ka marrë asnjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale, thjesht prania e tij në vendin e krimit do të bënte atë një dëshmitar. Gjithashtu, Gjykata Themelore ka harruar të vë në dukje se kontributi duhet të jetë i domosdoshëm. Përveç kësaj, koncepti i bashkëkryerësit përfshin të dy elementet, atë subjektiv dhe objektiv. Veprimet e **OI**-it që janë vërtetuar – d.m.th të qenit i pranishëm, ruajtja e pikës së kontrollit, duke e përkujtuar dikë që të ndjek urdhrat e tij dhe për të vepruar në përputhje me vendimin e tij të mëparshëm - nuk mund të përfshihen në kuadër të bashkëkryerjes. Më e rëndësishmja, ekzistimi i lëre më përmbajta e pretenduar e “planit të përbashkët” nuk janë vërtetuar nga Gjykata Themelore. Gjithashtu, pasi që Gjykata Themelore ka gjetur se “niveli i përfshirjes së të pandehurit në kryerjen e veprës penale është zvogëluar”⁵, **OI** nuk mund të ketë kontribuar ndjeshëm në kryerjen e veprës penale.

Aktakuza e ka ngarkuar **OI**-in për urdhërimin dhe / ose me nxitjen për kryerjen e veprës penale. Megjithatë, Gjykata Themelore ka konstatuar se ai nuk ka qenë fajtor për asnjërën nga to. Interpretimi i gjerë dhe kreativ i ligjit ashtu sic është kryer nga Gjykata Themelore për të

⁵ Aktgjykimi, paragrafi 319

mundësuar gjetjen e **OI**-it fajtor është i kundërligjshëm. Për më tepër, ligjet në fuqi në Kosovë nuk e njohin konceptin “ndërmarrje e përbashkët kriminale”. Pasi që **OI** nuk ka dhënë një urdhër, por thjesht ia ka kujtuar ushtarit tjetër përgjegjësinë e tij për të ndjekur urdhrat, elementi subjektiv, ose “*mens rea*”, i veprës penale nuk është përmbushur. Duke deklaruar “Pse po më pyet mua?” **OI** qartazi e mohon çdo përfshirje të tij. Në fund, **OI** nuk ka qenë në pozicion që të parandaloj kryerjen e veprës penale - e cila është një element i bashkëkryerjes.

c) Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke përfshirë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNJ);

Faktet e theksuara në aktakuzë dhe gjetjet e trupit gjykues nuk korrespondojnë me njëra tjetrën. Pasi që prokurori nuk e ka ndryshuar aktakuzën, aktgjykimi e ka tejkaluar shtrirjen e akuzave. Zbatimi i nenit 360 të KPP-së nga ana e Gjykatës Themelore ishte i gabuar dhe pa arsyetim ë duhur. Nëse lexohet në tërësinë e saj, ky nen lejon modifikimin e klasifikimit juridik të veprës penale, por jo modifikimin e përshkrimit faktik të veprimeve (identiteti i veprimeve). Këto shkelje kanë rezultuar me shkelje të të drejtave të mbrojtjes dhe kanë ndikuar në nxjerrjen e një aktgjykimi ligjor dhe të drejtë.

Modifikimi i përshkrimit faktik, pa një modifikim të Aktakuzës e ka shkelur të drejtën e të pandehurit që të përgatis mbrojtjen e tij në mënyrë të duhur. Modifikimi i cilësimit juridik nga Gjykata Themelore pa e informuar të pandehurin për këtë qëllim, gjithashtu e ka shkelur të drejtën e tij për një mbrojtje. Këto janë shkelje të gjykimit të drejtë, të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së.

d) përcaktimi i gabueshëm i sanksioneve penale;

Pasi që **OI** është dashur të lirohej nga të gjitha akuzat, çfarëdo dënimi është i padrejtë.

Prokurori Romulo Mateus në përgjigjen e tij të datës 3 maj 2016 mendon se ankesat janë të pabazuara. Ai kërkon që Gjykata e Apelit të hedh poshtë ankesat dhe që të aprovoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Në lidhje me dënimin ai i referohet ankesës së tij.

Si një vërejtje të përgjithshme Prokurori vëren se ankesa shtjellon jurisprudencën dhe doktrinën pa cituar referencat.

Në lidhje me gabimet e pretenduara procedurale Prokurori fillimisht vëren se aktgjykimi nuk ka vërtetuar ndonjë fakt që nuk ishin tashmë të përfshira në aktakuzë. Prandaj, aktgjykimi është i bazuar vetëm në Aktakuzë. Ndërsa Gjykata Themelore ka theksuar me të drejtë se, ajo nuk është e lidhur me kualifikimin ligjor të paraqitur nga Prokurori (Neni 360 (2) të KPP-së). Më tej, aktgjykimi është bazuar vetëm në provat e shqyrtuara në shqyrtimin kryesor. Të dy rregullat e brendshme dhe përcaktimet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut janë respektuar. Së dyti Prokurori thekson se **OI** në Gjykatën Themelore nuk e ka ngritur çështjen e dështimit për të hetuar si duhet çështjen, dhe në përputhje me nenin 382 (3) dhe (4) të KPP-së ky pretendim duhet të refuzohet. Së treti, Prokurori mendon se pasi që **OI** gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka kundërshtuar procedurën e vërtetimit të fakteve dhe

administrimin e provave, atij i ndalohet që ta bëjë këtë në fazën e apelit, sipas nenit 382 (3) dhe (4) të KPP-së. E njëjta gjë vlen edhe për pretendimet e **OI**-it për mungesën e sqarimit të fakteve të caktuara. Së katërti, pasi që të gjitha refuzime e parashtresave të **OI** janë të arsyeshme, Gjykata Themelore nuk e ka favorizuar prokurorinë.

Në lidhje me gabimet e pretenduara në zbatimin e ligjit, prokurori mendon se pretendimi i **OI**-it mbi shkeljen e parimit *ne bis in idem* nuk është i mjaft i saktë për t'i mundësuar prokurorisë që të komentojë për të. Më tej, pasi që kjo kërkesë është bërë vetëm në fazën e apelit, e njëjta duhet të refuzohet. Në lidhje me zbatueshmërinë e Protokollit II të Konventave të Gjenevës, Prokurori thekson se ekzistenca e një konflikti të brendshëm të armatosur në Kosovë në atë kohë ka qenë e vendosur si në jurisprudencën e Tribunalit të Hagës⁶ ashtu edhe në gjykatat në Kosovë. Në çdo rast, zbatueshmëria e nenit 3 të përbashkët nuk është sfiduar. Gjithashtu, Prokurori vë në dukje se disa nga rastet e cituara në ankesat e **OI**-it i referohen rasteve të vendosura në juridiksionet e huaja dhe kështu ato nuk janë të zbatueshme. E njëjta gjë vlen edhe për Statutin e Romës të GJNP⁷. Më tej, edhe pse Gjykata Themelore gabimisht i referohet “dashjes indirekte”, ajo në fakt e përshkruan “dashjen e drejtpërdrejtë” kur e përcakton dashjen e **OI**-it. Në lidhje me kriteret për bashkëkryerje, neni 22 i KPRSFJ-së i përcakton mënyrat e përgjegjësisë të ndryshme nga “kryerja e menjëhershme”. Kërkesat e bashkëkryerjes janë përmbushur plotësisht. Operacioni “fshirja” në Mitrovicë ishte një operacion tipik i pastrimit etnik i përbërë nga forcat e rregullta të armatosura, si dhe forcat e parregullta dhe ekzistimi i tij është vlerësuar me kujdes nga Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore dhe është i padiskutueshëm. Pyetja e drejtuar **OI**-it e bën atë një pjesëmarrës aktiv dhe e përjashton mundësinë e tij për të qenë një kalimtar apo një vëzhgues pasiv. Më tej, Gjykata Themelore e ka vlerësuar siç duhet se roli i **OI**-it ishte thelbësor, sepse fjalët e tija shkaktuan vrasjet.

Një qëllim i përbashkët mund të nxirret nga faktet konkrete, sikurse udhëzimi i përsëritur për largimin nga Kosova, veprimet e përbashkëta, trajtimi i vazhdueshëm i grupit të shqiptarëve etnikë dhe se nuk ka asnjë dyshim se ka pasur bindje ndaj udhëzimeve. Më tej, **OI** nuk duket i habitur, i tronditur apo i befasuar për të parë se ekzekutimet po zhvilloheshin aty pranë. Kështu, Gjykata Themelore me të drejtë ka konstatuar se **OI** ishte në dijeni të “planit të përbashkët” për të dëbuar dhe për të vrarë shqiptarët etnikë.

Parimi i *in dubio pro reo* nuk është shkelur. Gjykata Themelore ka shpjeguar me kujdes se si ka arritur në konkluzionet e saja.

Në lidhje me gabimet e pretenduara gjatë vërtetimit të gjendjes faktike, Prokurori vë në dukje se intervistat e procedurës paraprake nuk mund të përdoren si prova të drejtpërdrejta. Në vend të kësaj, ato mund të përdoren si një mjet për të vënë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarit, por vetëm nëse dëshmitari ballafaqohet me to. Gjithashtu, Gjykata Themelore ka adresuar mospërputhjet e vogla në intervistat e ndryshme në procedurën paraprake të **IM**, dhe ka dhënë

⁶ Prokurori i referohet Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991, e krijuar me Rezolutën 827 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nga data 25 maj 1993.

⁷ Prokurori i referohet Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (1998), U.N. Doc. A / Conf. 183/9 (1998), *ribotuar në* 37 I.L.M. 999 (1998). Më 17 korrik 1998, Konferenca e Diplomatie OKB-së e Plotfuqishmëve për Themelimin e një Gjykate Ndërkombëtare Penale e miratoi Statutin e Romës të GJNP.

një shpjegim se pse e konsideron deklaratën e tij të besueshme. Në kundërshtim me pretendimet e **OI**-it, prokurori e konsideron **IM** si një dëshmitar të besueshëm për shkak se deklarata e tij është shumë e detajuar; ai i drejtohet tërë asaj dite në të njëjtin nivel të detajuar; ai përdor ligjëratën e drejtë kur përshkruan deklaratat e të tjerëve dhe jep shpjegime për mospërputhjet; ai pranon, kur nuk e di përgjigjen në pyetje; ai nuk e kundërshton vetveten gjatë dëgjimit të tij të gjatë në Gjykatë; madje edhe në momentet më emocionale ai dëshmoi vetëm për atë që kishte dëgjuar dhe konkluzionet e tij nga ajo; dhe menjëherë pas incidentit ai e ka identifikuar Ivanoviqin si kryerës për të mbijetuarit e tjerë. Sa i përket dëshmisë së **SK**, prokurori mendon se ajo nuk është në kundërshtim me dëshminë e **IM**. Përveç kësaj, dëshmia e **K** është prekur në mënyrë të qartë nga ngjarjet traumatike, sepse atij i kujtohen konkretisht vetëm pikat kryesore. Edhe kështu, mospërputhjet janë shumë të vogla, në përjashtim të njerës. Në lidhje me rëndësinë e dhënë dëshmitarëve **C, P, LI, A, B** dhe **M**, Prokurori i referohet ankesës së tij.

Prokurori thekson se mbrojtja nuk e ka kundërshtuar asnjërën nga mangësitë e pretenduara, duke i vënë në pyetje dëshmitarët, ose duke e kundërshtuar procedurën penale.

OI e keqinterpreton situatën dhe i shtrembëron fjalët e dëshmitarëve dhe të gjykatës, p.sh. duke mos i parashtruar disa pyetje të caktuara; duke e injoruar provën se **OI** ka qenë anëtar i rezervave të forcave të policisë speciale në atë kohë; duke e nënvizuar një mospërputhje të rreme të dëshmimeve dhe të vendit ku u gjetën trupat; duke pretenduar mospërputhje në përshkrimin e sulmit; dhe duke pretenduar identifikimin e gabuar të uniformë së tij. Më tej, Gjykata Themelore tërësisht dhe në thellësi e ka shqyrtuar alibinë e **OI**-it dhe ka arritur në gjetjet e mirë-bazuara.

Si vërejtje përfundimtare Prokurori vë në dukje se parashtrësia e **OI** shpreh tendencat nacionaliste. Gjithashtu, ai thekson njohuritë e brendshme që vetëm personat e përfshirë në veprimtaritë e luftës në atë kohë mund t'i kenë njohur.

IV. PROPOZIMI I PROKURORIT TË APELIT

Prokurori i Apelit, Claudio Pala në parashtrësien e tij të datës 1 korrik 2016 i propozon Gjykatës së Apelit që të refuzojë ankesat e **OI** -it në tërësinë e tyre dhe që të aprovoj ankesën e PSRK-së në tërësi.

Prokurori i Apelit pajtohet me PSRK-në.

Ai më tej pohon se trupi gjykues është angazhuar në një ushtrim artificial të analizimit të çdo pjese të provave rrethore në izolim. Megjithatë, nga provat është e qartë se **OI** ishte në fakt një epror i ekzekutuesve. Inkurajimi i fundi për të ekzekutuar të burgosurit erdhi nga **OI**. Ekzekutuesit i kanë kryer vrasjet menjëherë pas fjalëve të të pandehurit, në kuptimin e plotë të fjalës, disa metra larg pikës së kontrollit. Në minimumin absolut, provat tregojnë se nga shkëmbimi i bisedës mes tij dhe udhëheqësin e rojeve, **OI** e ndihmoi dhe e inkurajoi kryerjen e veprave me të cilat ngarkohet në Pikën 1 të Aktakuzës.

Faktet që **OI** e ka urdhëruar kryerjen e veprës penale, ka keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij dhe ka qenë në posedim të një dashje diskriminuese, duhet të konsiderohet si fakt rëndues.

Mbështetja e trupit gjykues në nivelin e “reduktuar” të pjesëmarrjes në veprën penale për këtë arsye është e diskutueshme. Prokurori i Apelit pajtohet me Prokurorinë Speciale dhe konstaton se dënimi i shqiptuar, dukshëm është shumë i ulët.

Në lidhje me akuzën 2 Prokurori i Apelit i referohet disa dëshmime të dëshmitarëve dhe letrës së rekomandimit dhe thekson se struktura, funksionimi dhe udhëheqja në Rojet e Urës ka dalë nga provat dhe ato e vërtetojnë njëra-tjetrën. Të gjitha provat janë reciprokisht vërtetuese në lidhje me strukturën dhe qëllimin e Rojet e Urës dhe për rolin kryesor të ushtruar brenda saj në kohën përkatëse nga i pandehuri **OI**.

Trupi gjykues ka gabuar kur nuk e ka lejuar prokurorinë që të përballë Dëshmitarin X me deklaratat e tija të mëparshme pasi që kjo është një “armë” parashtrimit të pyetjeve të tërthorta. Pasi që Dëshmitari X ishte një dëshmitar kyç, gabimi i trupit gjykues i ka shkaktuar dëme të pariparueshme rastit të prokurorisë. Besueshmëria e tij nuk ka mundur të sfidohet në mënyrë efektive. Megjithatë, marrja në pyetje ose dëgjimi i dëshmitarit është i kufizuar vetëm në rrethanat që radhiten në nenin 257 (4) të KPP-së.

Lidhur me incidentin e datës 3 shkurt 2000, trupi gjykues nuk ka marr parasysh provat relevante të Dëshmitarit Y që tregojnë se i pandehuri ishte iniciues i ngjarjeve të asaj dite.

Prokurori i Apelit konsideron se pavarësisht anonimitetit të dhënë nga trupi gjykues, mbrojtja e Delibashiq ishte në dijeni të identitetit të Dëshmitari X. Për këtë arsye, i pandehuri nuk kishte të drejtë në mbrojtje sipas nenit 262 (3) të KPP-së.

Gjykata ka gabuar duke e përjashtuar lidhjen shkakësore midis nxitjes për kryerjen e krimeve të Delibashiq dhe *actus reus*. I vetmi konstatim i arsyeshem është se të paktën disa nga kryerësit e drejtpërdrejtë të krimeve që përmenden në Aktakuzë ishin të vetëdijshëm dhe të ndikuar nga nxitja e **DD**-it për të pastruar zonën nga shqiptarët e Kosovës. Ai e nxiti kryerjen e krimeve sipas pikës 2 të Aktakuzës.

Duke iu përgjigjur ankesave të mbrojtjes, ai i referohet standardeve ligjore për çdo ndërhyrje të apelit në fushën e vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarit. Avokati mbrojtës dhe **OI** përpiqen që të diskreditojnë identifikimin nga ana e dëshmitarëve dhe kujtesën e pranisë së tij në zonën e pikës së kontrollit. Dëshmia e qartë e dhënë nga dëshmitarët **M** dhe **K** vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve **C**, **P**, dhe **L** të cilët u dëbuan nga shtëpitë e tyre në të njëjtin rast dhe bashkëvepruan me të pandehurin. Përkundrazi, dëshmitë e propozuara nga ana e mbrojtjes vetëm ofrojnë informacion të përgjithshëm dhe kundërshtohen. Provat nuk lënë asnjë vend për të dyshuar se viktimat u qëlluan me përcjellje të tyre.

Pretendimi për shkelje të parimit *ne bis in idem* nuk qëndron dhe duhet të hidhet poshtë. Prokurori konsideron se kur bëhet fjalë për një cilësimin ligjor të veprës në aktakuzë, trupi gjykues nuk është i kufizuar me klasifikimin ligjor të propozuar nga prokurori. Pohimi se ri-klasifikimi lejohet vetëm nëse kjo nuk është në dëm të të pandehurit, nuk mbështetet nga leximi i KPP-së. Për më tepër, ka pasur një plan për vrasjen e disa meshkujve të përzgjedhur shqiptar dhe **OI** kishte njohuri për një plan të tillë. Ai njoftua për pretendimet në lidhje me të gjitha elementet

që janë përdorur më pas nga trupi gjykues në gjetjen e tij si përgjegjës për vrasjet në cilësi të një bashkëkryerësi. Neni 6 i KEDNJ-së nuk është shkelur.

Prokurori i Apelit mendon se plani për operacionet “fshirja” përfshinin vrasjet e të paktën disa prej shqiptarëve të aftë Kosovës. Ka pasur një plan për likuidimin e të paktën disa njerëzve të aftë, të dyshuar me sa duket për lidhjet e tyre me UÇK-në. Në minimum, vrasjet ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të një shkallë të gjerë të një lëvizje të dhunshme dhe të detyruar të popullatës.

OI ka pasur ndikim në mesin e “të kaltërve”, dhe ishte *de jure* ose *de facto* epror i tyre. Ai ka marrë pjesë në ekzekutimin e planit të përbashkët, duke vendosur njerëz në pikën e kontrollit dhe duke e përdorur ndikimin e tij për t’u bërë thirrje ekzekutuesve që të zbatonin urdhrin e tyre për të vrarë njerëzit e zgjedhur më parë, shqiptarë të Kosovës, fizikisht të aftë. Ai zotëronte *mens rea* të nevojshme. Bazuar në atë që u tha më lart, trupi gjykues nuk ka gabuar kur ka gjetur se **OI** ka qenë bashkëkryerës i veprave penale me të cilat ngarkohet në pikën 1 të Aktakuzës.

I. GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT

A. Kompetenca e Trupit Gjikues të Gjykatës Themelore

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar kompetencën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe pasi që nuk ka janë ngritur kundërshtime nga palët është vepruar si më poshtë:

Më 23 mars 2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë vendimin nr. 25/2015 për aprovimin e kërkesës nga EULEX-i për të vazhduar gjykimin. Në vendim thuhet “*Çështja e cila është aktualisht është duke u shqyrtuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës do të mbetet tek gjyqtarët e EULEX-it.*” Ajo më tej thotë: “... konfirmohet se rasti i mësipërm do të gjykohet nga gjyqtarët e EULEX-it pasi që kjo çështje është një “rast në proces”...”

Në pajtim me Ligjin për Gjykatat, si dhe Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që lidhen me Mandatin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (Ligji nr. 04 / L-273), si dhe Marrëveshjes ndërmjet kreut të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, Kolegji konstaton se EULEX-i kishte kompetencë mbi rastin dhe se Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore ka pasur kompetencë për të vendosur mbi çështjen në përbërje të Gjyqtarëve të EULEX-it.

B. Kompetenca e Kolegjit të Gjykatës së Apelit

Avokatët mbrojtës kanë ngritur një kundërshtim ndaj anëtarit të kolegjit Driton Muharremi. Në bazë të nenit 42 (1.3) të KPP ky kundërshtim i është dërguar Kryetarit të Gjykatës së Apelit. Më 6 tetor 2016, Kryetari i Gjykatës së Apelit e hodhi poshtë kërkesën si të pabazuar. Gjithashtu, në bazë të nenit 472 (1) të KPP-së, Kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e tij. Kolegji konstaton si në vijim:

Për shkak të ndryshimit të mandatit të EULEX-it dhe të ligjit të ri nr. 05 / L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me Mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, Kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it përmes një letre nga data 22 gusht 2016, ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës caktimin e një kolegji të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe të caktoj njërin nga gjyqtarët e EULEX-it, si kryetar të kolegjit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 27 shtator 2016, ka lëshuar një vendim për aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it për të vendosur çështjen në kolegjin e përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it, dhe me një gjyqtar të EULEX-it si kryetar të kolegjit.

Kolegji konstaton se EULEX-i ka kompetencë mbi rastin dhe se kolegji është kompetent për të vendosur mbi çështjen përkatëse në përbërjen të dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari të apelit të Kosovës.

C. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 21 janar 2016. Aktgjykimi i formës së shkruar u është dorëzuar të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit të EULEX-it, sic u tha më lart. Ankesat janë paraqitur brenda afatit 15 ditor në pajtim me nenin 380 (1) të KPP-së. Ankesat janë paraqitur nga personat e autorizuar.

Ankesat përmbajnë të gjitha informacionet e tjera në bazë të nenit 382 *et seq* të KPP-së. Për këtë arsye ato janë të pranueshme.

Kolegji i Apelit do të diskutoj të gjitha bazat e ankesë së ngritur nën titujt përkatës në vijim:

D. Gjetjet mbi meritat - Akuza 1

D.1. Shkeljet e kodit të procedurës penale

Ne bis in idem

Kolegji rikujton Nenin 4 (1) të KPP-së që thotë “*Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale, nëse ai ose ajo është liruar ose dënuar me një vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij ose asaj është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza kundër tij ose asaj, ose është refuzuar me vendim të formës së prerë.*”

Gjithashtu, Kolegji përkujton Nenin 385 (1.3) të KPP-së i cili parasheh “*Ka një shkelje të ligjit penal: ... ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë; ...*”

Së fundi, Kolegji përkujton Nenin 363 (1.2) të KPP-së i cili parasheh “*Gjykata merr aktgjykim*

me të cilin akuza refuzohet kur: ... i akuzuari për të njëjtën veprë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose **procedura kundër tij** është pushuar me aktvendim të formës së prerë; ... “. Kolegji konstaton se fjala “duhet” i referohet një detyrimi, dhe kështu Gjykata Themelore është dashur të ketë vendosur mbi këtë sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i ankimuar përmend se dëshmitari **BM** ka qenë “gjqqtar hetues në atë kohë ...”⁸. Në deklaratën e tij dëshmitari **BM** thekson se ai “... kishte nënshkruar procesverbalin mbi vërtetësinë e gjetjeve. E nënshkrua para gjyqtarit të Dhomës së Posaçme për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd.”⁹

Gjykata Themelore u njoftua edhe për mundësinë e zbatimit të parimit *ne bis in idem* në lidhje me këtë akuzë, ndërsa më 24 mars 2015 prokurori deklaroi “... kemi gjetur disa informata se ka pasur një dosje të lëndës së kompletuar të këtij hetimi të veçantë dhe se ajo duhet të jetë në **R** apo **K** dhe kërkojmë nga prokuroria në Beograd për të marrë një kopje të dosjes së lëndës.”¹⁰

Më tej, dosja përmban një dokument të UNMIK-ut¹¹ “shkresë ndër-zyrtare” nga data 22 shtator 2000, nga Jean Pinet, CCIU Prishtinë. Ndër të tjera, në lidhje me **OI**-in thuhet se sipas dëshmitarit **BM** është dërguar një raport në Gjykatën e Qarkut në **R** ose **K**, dhe se “Dokumentet në lidhje me këtë person tashmë kanë kaluar tek prokurori ndërkombëtar.” Në dokument konstatohet se “siç kërkohet nga prokurori ndërkombëtar në Mitrovicë, ky dokument kalon tek ky gjyqtar, në mënyrë që të përcaktohet nëse ka elemente të mjaftueshme për ngritjen e akuzave për të ndjekur penalisht të dyshuarin për krime të luftës, siç përcaktohet në ligjin penal të RFJ-së, kapitulli 6, neni 142.”

Dëshmitari **MH** ka dëshmuar se ka pasur një hetim nga ana e xhandarmërisë franceze që çoi në parashtrimin e kërkesës për fillimin e hetimit. **H** “... në cilësinë e gjyqtarit, lëshoi një vendim për të filluar veprimet hetimore në atë kohë ... të udhëhequr nga oficeri hetues nga Kanada ... i cili e kreu hetimin ...”¹²

Gjithashtu, në fjalën e tij përmbyllëse, avokati mbrojtë Nebojša Vlajić rikujton se një gjyqtar ndërkombëtar dhe një prokurori publik i UNMIK-ut i kanë vlerësuar provat, duke shkaktuar parimin e *ne bis in idem*.¹³

Si përfundim, Gjykata e Apelit u vë në njoftim se një veprim zyrtar ishte ndërmarrë në lidhje me veprën e përshkruar në akuzën 1. Pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk kishte dhënë asnjë sqarim për këtë çështje, Gjykata e Apelit mbajti një seancë për të sqaruar çështjen.

Në seancën dëgjimore në Gjykatën e Apelit më 22 nëntor të vitit 2016, dëshmitari **H** ka deklaruar se kishte filluar një hetim kundër 6-7 personave, asnjëri prej të cilëve nuk ishte **OI**-i. Gjatë hetimeve 2 ose 3 dëshmitarë e implikuan **OI** -in, por në atë kohë nuk ishte e mundur që ai

⁸ Aktgjykimi, titulli “njerëzit e vrarë”, paragrafi 113.

⁹ Procesverbali, 24 mars 2015, paragrafi 21.

¹⁰ Procesverbali, 24 mars 2015, paragrafi 30.

¹¹ Regjistratori III, Prova të dokumentuara, f. 705 – 711.

¹² Procesverbali, 26 mars 2015, paragrafi 29.

¹³ Procesverbali, 17 dhjetor 2015, paragrafi 10, f. 5 e versionit në gjuhën angleze.

të hetohej dhe kështu hetimet nuk u zgjeruan për të përfshirë **OI**-in. Në vend të kësaj, deklaratat e dëshmitarëve iu dorëzuan njësisë CCIU të UNMIK-ut e cila merrej me krimet e luftës.

I pandehuri **OI** gjithashtu pranoi se para vitit 2014 ai nuk ishte ftuar në lidhje me ngjarjet e 14 prillit të vitit 1999.

Avokati mbrojtës i **OI** u pajtua që gjyqtari hetues **H** nuk kishte marrë asnjë veprim formal, pasi dëshmitarët e implikuan **OI**-in. Megjithatë, mbrojtja ende vlerëson se parimi i *ne bis in idem* duhet të zbatohet. Mbrojtësi kishte tre linja të argumentimit: së pari, hetimi në atë kohë është dashur të zgjerohej për të përfshirë **OI**-in dhe dështimi i prokurorit për të bërë këtë nuk duhet të jetë në dëm të të pandehurit. Prandaj, duhet të supozohet se ai është hetuar dhe se hetimi ka përfunduar para fazës së aktakuzës dhe parimi i *ne bis in idem* duhet të zbatohet; së dyti, pasi që dëshmitë / provat janë vlerësuar më parë si të papranueshme dhe / ose jo të besueshme në një rast në lidhje me një tjetër të pandehur, kjo provë tani nuk mund të vlerësohet në mënyra të ndryshme; së treti, parimi i sigurisë juridike kërkon që provat e mbledhura 17 vjet më parë nuk janë të ricikluara dhe të riaktivizuara.

Në fjalën e tij përfundimtare Prokurori i Apelit e njoftoi Gjykatën se përgjigja nga Republika e Serbisë me kërkesë të Prokurorit në lidhje me **OI**-in ka qenë se ata i kanë dërguar të gjitha materialet që i kanë, përkatësisht një deklaratë të dëshmitarit dhe procesverbalin e inspektim të vendit.

Kolegji përkujton se neni 4 (1) i KPP-së kërkon një vendim formal dhe përfundimtar në lidhje me të akuzuarit. Kolegji vëren se nuk është e diskutueshme se nuk ka pasur hetime formale në lidhje me **OI**-in dhe për këtë arsye nuk është lëshuar asnjë vendim formal. Kolegji më tej thekson se argumentet e mbrojtjes nuk janë të bazuara në ligj. **Prandaj, Kolegji konstaton se parimi i ne bis in idem nuk mund të zbatohet për I -in në lidhje me Akuzën 1.**

Mospërputhja mes dispozitivit të shpallur dhe të shkruar

Kolegji rikujton nenin 370 (1) të KPP-së, i cili thotë “*Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë plotësisht në përputhje me aktgjykimin e shpallur.*”

Kolegji vëren se procesverbali i shqyrtimit kryesor i datës 21 janar 2016 deklaron “*3. Aktgjykimi është duke u lexuar.*”¹⁴ Shkresat e lëndës përfshijnë një dokument¹⁵ të datës 21 janar, 2016 dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues të gjykatës themelore. Ky dokument është aktgjykimi i cili u lexua.

Kur krahasojmë dokumentin e përmendur më lart dhe aktgjykimin, Kolegji konstaton se në lidhje me dispozitivin e akuzës 1 ato janë identike. Prandaj, Kolegji konstaton se nuk ka mospërputhje në mes të gjyqimit të shpallur dhe aktgjyqimit në formë të shkruar.

Korrespondenca e dispozitivit dhe arsytimit të aktgjyqimit

¹⁴ Procesverbali i shqyrtimit kryesor, paragrafi 3 (me germa kursive).

¹⁵ Regjistratori 14, dokumenti 9.

Dispozitivi i aktgjykimit i përmend faktet të cilat i ka vërtetuar Gjykata Themelore përtej dyshimit të arsyeshëm¹⁶. Ndër të tjera, është konstatuar se “... **OI** ishte pjesë e një grupi paramilitarësh / policëve të pranishëm në pikën e kontrollit.”, se “Ai kishte të veshur një uniformë me ngjyrë të kaltër dhe ishte i armatosur.”, se në pyetjen e drejtuar **OI**-it nga njëri prej burrave që e shoqëronin grupin e personave, katër prej të cilëve u vranë më vonë, **OI** “... u përgjigj në kuptimin: “Pse po më pyesni mua, zbatoni urdhrat!””, dhe në fund se “... **OI** ishte në dijeni të operacionit për dëbimin dhe vrasjen e shqiptarëve etnikë civilë ... duke vepruar siç përshkruhet më sipër, ai me vetë-dëshirë iu bind planit, duke e ditur se kjo do të rezultojë me vrasje. “Dispozitivi më tej thekson se nuk është mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se **OI** “... ka vepruar në cilësinë e një udhëheqësi... “ ose se ai “... e ka nxitur grupin ... duke i urdhëruar ata”.

